



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 32

Tiranë – E hënë, 9 mars 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 7/2015 datë 12.2.2015	Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 10 083, datë 23.2.2009, “Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoritet kontraktues, dhe EVN AG, Statkraft AS e Devoll Hydropower, sh.a., si bashkëkoncesionarë për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll, në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....
	1433
Ligj nr. 8/2015 datë 19.2.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.....
	1444
Ligj nr. 9/2015 datë 19.2.2015	Për medaljet në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.....
	1452
Ligj nr. 10/2015 datë 19.2.2015	Për disa ndryshime në ligjin nr. 112/2013, “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”.....
	1456
Ligj nr. 11/2015 datë 19.2.2015	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen shumëpalëshe ndërmjet vendeve të Europës Juglindore për zbatimin e konventës “Për vlerësimin e ndikimit mjedisor në kontekst ndërkufitar”.....
	1456
Vendim i Kuvendit nr. 35/2015 datë 26.2.2015	Për disa ndryshime në strukturën, organikën dhe kategorizimin e pozicioneve të punës të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA)...
	1461
Vendim i Kuvendit nr. 36/2015 datë 26.2.2015	Për zgjedhjen e zonjës Denada Prifti anëtare e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.....
	1464



LIGJ
Nr. 7/2015

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË
LIGJIN NR. 10 083, DATË 23.2.2009, “PËR
MIRATIMIN E KONTRATËS SË
KONCESIONIT NDËRMJET MINISTRISË
SË EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS, SI AUTORITET
KONTRAKTUES, DHE EVN AG,
STATKRAFT AS E DEVOLL
HYDROPOWER, SH.A., SI
BASHKËKONCESIONARË PËR
PROJEKTIMIN, FINANCIMIN,
NDËRTIMIN, MARRJEN NË PRONËSI,
SHFRYTËZIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE
TRANSFERIMIN E PROJEKTIT TË
HIDROCENTRALIT NË LUMIN
DEVOLL, NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në titull dhe kudo në ligj, emërtimi “Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës” zëvendësohet me emërtimin “Ministria e Energjisë dhe Industrisë”.

Neni 2

Miratimin e shtesës së tretë të kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, si autoritet kontraktues, dhe EVN AG, Statkraft AS dhe Devoll Hydropower, sh.a., si bashkëkoncesionarë për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll, në Republikën e Shqipërisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 3

Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Financave, Ministria e Transportit dhe

Infrastrukturës, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij ligji.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 12.02.2015

Shpallur me dekretin nr. 8983, datë 26.2.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani

SHTESA E 3-TË

**E KONTRATËS SË KONCESIONIT
NË LIDHJE ME PROJEKTIMIN,
FINANCIMIN, NDËRTIMIN, MARRJEN
NË PRONËSI, SHFRYTËZIMIN,
MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN
E PROJEKTIT TË HIDROCENTRALIT
NË LUMIN E DEVOLLIT NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË MES
MINISTRISË SË EKONOMISË,
TREGTISË DHE ENERGJETIKËS (SI
AUTORITETI KONTRAKTUES) DHE
STATKRAFT AS DHE DEVOLL
HYDROPOWER SHA (SI
BASHKËKONCESIONARË)**

Kjo shtesë e 3-të lidhet mes Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë si Autoriteti Kontraktues dhe Statkraft AS, dhe Devoll Hydropower sh.a., si bashkëkoncesionarë (në vijim e quajtur “Marrëveshja” ose “Shtesa e 3-të”).

— dhjetor 2014

Kjo shtesë e 3-të e Kontratës së Koncesionit për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Projektit të Hidrocentralit në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë e lidhur më datë 19 dhjetor 2008, e cila është miratuar nga Parlamenti Shqiptar nëpërmjet ligjit nr. 10083, datë 23 shkurt 2009 dhe e publikuar në Fletoren Zyrtare shqiptare nr. 28, datë 17 mars 2009, dhe plotësuar nga shtesa e 1-rë e Kontratës së Koncesionit datë 3 gusht 2010, e cila është miratuar me ligjin nr. 10337, datë 21 tetor 2010



dhe publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 154, datë 24 nëntor 2010 dhe plotësuar nga shtesa e 2-të e Kontratës së Koncesionit datë 19 mars 2013, e cila është miratuar me ligjin nr. 105/2013, datë 28 mars 2013 dhe publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 53, datë 15 prill 2013 (Kontrata e Koncesionit), lidhet sot me ____ dhjetor 2014, midis:

1. Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë së Republikës së Shqipërisë, ish-Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), e ndodhur në blv. “Dëshmorët e Kombit”, 1001 Tiranë, Shqipëri, (“MEI” ose “Autoriteti Kontraktues”), dhe

2.a) Statkraft AS, një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit të Mbretërisë së Norvegjisë me seli në Lilleakerveien 6, 0283 Oslo, Norvegji, dhe e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Norvegjisë me numër shoqërie 987 059 699 (Statkraft);

b) Devoll Hydropower sh.a., një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, me seli në adresën: rr. “Papa Gjon Pali II”, ABA Business Center, zyra nr. 1204, Tiranë, Shqipëri dhe e regjistruar në regjistrin tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit e Republikës së Shqipërisë (Shoqëria e Projektit),

Secili referuar si “Bashkëkoncesionarët” dhe së bashku “Koncesionari”.

Secili prej Autoritetit Kontraktues, Bashkëkoncesionarëve do të quhen individualisht “Pala” dhe bashkërisht “Palët”.

Meqenëse

A. Bazuar në vendimin nr. 833, datë 18.9.2013 të Këshillit të Ministrave, Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI) është përgjegjëse për administrimin e sektorit të energjisë dhe ka trashëguar të drejtat dhe detyrimet e ish-Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

B. Në përputhje me nenin 7.2.6 të Kontratës së Koncesionit, Autoriteti Kontraktues është përgjegjës, i vetëm, për ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese me shpenzimet e tij.

C. Sipas nenit 7.2.6 të Kontratës së Koncesionit dhe marrëveshjes “Për mënyrën e pagesave në lidhje me Infrastrukturën Zëvendësuese (“rugët

dhe urat”) të lidhur midis Shoqërisë së Projektit, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe Autoritetit Rugor Shqiptar më 5.9.2013 “Marrëveshje mbi mënyrën e pagesës” është rënë dakord se shuma që Koncesionari do t’i paguajë Autoritetit Kontraktues si kompensim për Infrastrukturën Zëvendësuese do të jetë 10.550.000 euro (dhjetë milionë e pesëqind e pesëdhjetë mijë euro).

D. Autoriteti Kontraktues është në vonesë në përmbushjen e detyrimit në lidhje me planifikimin, projektimin dhe ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese dhe nuk ka arritur të sigurojë fondet e nevojshme për planifikimin, projektimin dhe ndërtimin e saj.

E. Ministria e Energjisë dhe Industrisë i kërkoi Koncesionarit në mbledhjen e datës 10.10.2013 gjetjen e një zgjidhjeje alternative për financimin, projektimin dhe ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese për shkak të mungesës së fondeve.

F. Shoqëria e Projektit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Autoriteti Rugor Shqiptar (ARRSH), në datë 14.2.2014, lidhën një kontratë “Në lidhje me projektimin dhe tenderimin e Infrastrukturës Zëvendësuese (Rrugët dhe Urat) dhe ndërtimin e rrugës M15 të Infrastrukturës Zëvendësuese të Moglicës” (Marrëveshja e Infrastrukturës Zëvendësuese), me anë të së cilës Shoqëria e Projektit mori përsipër të projektonte dhe kryente procedurën e tenderimit të Infrastrukturës Zëvendësuese, si dhe të ndërtonte rrugën M15 të Infrastrukturës Zëvendësuese të Moglicës, me kusht që palët të nënshkruanin një shtesë të Kontratës së Koncesionit me anë të së cilës Koncesionari merr përsipër detyrimin të projektojë, tenderojë dhe ndërtojë Infrastrukturën Zëvendësuese kundrejt një kompensimi të drejtë dhe të kënaqshëm për shpenzimet shtesë të saj.

G. Parlamenti i Shqipërisë ka miratuar së fundmi rritjen e disa taksave, duke përfshirë por pa u kufizuar, rritjen e shkallës tatimore të tatimit mbi fitimin në 15% (nga 10%) dhe rritjen e taksës së qarkullimit për karburantin në 17 lekë për litër (nga 7 lekë për litër). Nenet 2.4.3 dhe 2.4.4 të Kontratës së Koncesionit parashikojnë zhdëmtimin e Koncesionarit kundrejt përgjegjësive apo kostove të lindura nga vendosja apo një rritje e taksave nëse plotësohen kushte të caktuara dhe Palët tashmë



dëshirojnë të rregullojnë në mënyrë më të detajuar mekanizmat e zbatueshëm lidhur me këtë zhdëmtim.

Për këtë arsye, duke marrë parasysh sa më lart, Palët bien dakord si vijon:

1. INTERPRETIMI

Çdo fjalë me gërmë të madhe e cila nuk është përkufizuar në shtesën e 3-të do të ketë kuptimin që i është dhënë kësaj fjale në Kontratën e Koncesionit.

2. NDRYSHIMET

2.1 Në nenin 1 të Kontratës së Koncesionit, përkufizimet e “Kushtet e Kokel” dhe “NBK e Parashikuar” do të shfuqizohen dhe përkufizimet e mëposhtme do të ndryshohen si vijon:

“Autoriteti Kontraktues” nënkupton Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë së Republikës së Shqipërisë.

“Data e Përfundimit të Punimeve të Ndërtimit sipas Grafikut” nënkupton datën që bie 90 muaj pas Datës së Fillimit të Punimeve të Ndërtimit.

“Kontraktori i Nivelit 1” nënkupton një kontraktor të drejtpërdrejtë të Shoqërisë së Projektit të emëruar nga Shoqëria e Projektit në përputhje me nenin 2.8.5 dhe një Kontraktor të Infrastrukturës Zëvendësuese”.

“Kontraktori i Nivelit 2” nënkupton një kontraktor të drejtpërdrejtë të çdo Kontraktori të Nivelit 1 të emëruar nga Shoqëria e Projektit në përputhje me nenin 2.8.5 dhe një Kontraktor të Infrastrukturës Zëvendësuese”.

“Kapaciteti i Transferimit Neto” do të thotë magnitudat maksimale të parashikuara të programeve të shkëmbimit të cilat mund të operohen midis dy fushave në përputhje me kushtet e sigurisë N-1 të fushave të përfshira.

“Hidrocentralet” do të thotë Hidrocentrali i Banjës dhe Hidrocentrali i Moglicës dhe mund të përfshijë Hidrocentralin e Kokelit, me kusht që Koncesionari të zgjedhë të ndërtojë Hidrocentralin e Kokelit”.

“NBK Minimale e Nevojshme” nënkupton një NBK totale prej 15% (pesëmbëdhjetë për qind)”.

“Taksë e Pagueshme” nënkupton çdo shumë takse, e cila është e kërkueshme në bazë të ligjit dhe e pagueshme nga Koncesionari kundrejt autoriteteve tatimore ose doganore për aktivitetin e tij në Shqipëri.

2.2 Përkufizimet e mëposhtme do të përfshihen në nenin 1 të Kontratës së Koncesionit sipas rastit:

“Marrëveshja e Infrastrukturës Zëvendësuese” nënkupton marrëveshjen e lidhur më datë 14.2.2014 midis Autoritetit Kontraktues, Shoqërisë së Projektit dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar për projektimin, tenderimin e Infrastrukturës Zëvendësuese (rrugët dhe urat) dhe ndërtimin e Rrugës M15 të Infrastrukturës Zëvendësuese të Moglicës, bashkëngjitur si Aneksi III.

“Kontraktori i Infrastrukturës Zëvendësuese” nënkupton kontraktorin e angazhuar për qëllime të zbatimit të çdo pune projektimi, planifikimi dhe ndërtimi ose punëve të tjera në lidhje me Infrastrukturën Zëvendësuese.

“Kosto e Infrastrukturës Zëvendësuese” do të ketë kuptimin e dhënë në nenin 7.2.7.3 të kësaj Marrëveshjeje.

2.3 Pika (ii) e paragrafit (d) të nenit 2.2.1 të Kontratës së Koncesionit ndryshohet si vijon:

“(ii) Koncesionari të plotësojë kërkesat e Autoritetit Kontraktues ose të Rregullatorit për të vepruar sipas detyrimeve të shërbimit publik, siç përcaktohet aktualisht në nenin 25 të ligjit nr. 9072 datë 22 maj 2003 “Për sektorin e energjisë”. Koncesionari do të kompensohet brenda tridhjetë (30) ditësh nga Autoriteti Kontraktues për ndonjë rënie në të ardhurat ose rritje në kosto, të cilat ai mund t’i pësojë për shkak të përmbushjes së këtyre detyrimeve ose për shkak të ndonjë kufizimi tjetër ligjor të cilat ndalojnë Koncesionarin të shesë ose eksportojë ndonjë pjesë të Prodhimit Neto të Energjisë Elektrike brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

Në rast se Autoriteti Kontraktues nuk paguan shpërblim për ndonjë kërkesë për rënie në të ardhura dhe/ose rritje të kostove, që duhet t’i paguhen Koncesionarit dhe kjo gjë nuk është korrigjuar brenda dyzet e pesë (45) ditësh pasi është dërguar njoftimi me shkrim për uljen e të ardhurave dhe/ose rritjen e kostove tek Autoriteti Kontraktues, Koncesionari ka të drejtë të kompensojë çdo Tarifë Koncesioni të pagueshme sipas nenit 4.1 të Kontratës së Koncesionit dhe çdo e të gjitha Taksat e Pagueshme kundrejt shpërblimit të lartpërmendur, në përputhje me parimet e nenit 7.2.7.6; dhe”.



2.4 Në nenin 2.4.3 shkronja (a) pika (i) fjalët “20%” do të fshihen, me efekt për rritjet e taksave që ndodhin mbas Datës Efektive të kësaj Shtese të 3-të.

2.5 Një nen i ri 2.4.5 do të shtohet pas nenit 2.4.4 të Kontratës së Koncesionit:

“2.4.5 Për qëllimet e zbatimit të neneve 2.4.3 dhe 2.4.4 të kësaj Kontrate, jo më vonë se 10 ditë përpara datës së caktuar për pagesën e çdo Takse të Pagueshme, Koncesionari do të bëjë një vlerësim të taksave shtesë të lindura nga vendosja ose rritja e një Takse (Taksat e Rritura të Koncesionarit) dhe çdo kosto shtesë që do të përballohet nga Koncesionari për shkak të pagesave të rritura tek kontraktorët e tij të lindura nga vendosja ose rritja e një takse e cila i zbatohet kontraktorëve (Pagesat e Rritura të Koncesionarit ndaj Kontraktorëve) dhe do t’i dërgojë Autoritetit Kontraktues një njoftim lidhur me Taksat e Rritura të Koncesionarit dhe të Pagesave të Rritura të Koncesionarit ndaj Kontraktorëve (së bashku referuar si “Kostot e Rritura të Koncesionarit”).

Koncesionari ka të drejtë:

i) të mbajë çdo pagesë të Taksave të Rritura të Koncesionarit;

ii) të rimbursojë shumën e Pagesave të Rritura të Koncesionarit ndaj Kontraktorëve nëse nuk ka taksa të pagueshme. Rimbursimi do të kryhet brenda 60 ditëve nga data e njoftimit që Shoqëria e Projektit i dërgon Autoritetit Kontraktues dhe autoriteteve përkatëse tatimore për të kërkuar rimbursimin; dhe

iii) të zbresë çdo Takse tjetër të Pagueshme të Koncesionarit nga shuma e Pagesave të Rritura të Koncesionarit tek Kontraktorët nëpërmjet mekanizmit të kompensimit që do të realizohet në përputhje me rregullat e kompensimit të parashikuara në Kontratën e Koncesionit dhe udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Energjisë dhe Industrisë që do të miratohet për zbatimin e neneve mbi taksat të kësaj Kontrate Koncesioni.

Për të shmangur çdo dyshim, kontratat midis Koncesionarit dhe kontraktorëve rregullojnë nëse kontraktorët kanë ndonjë të drejtë për të faturuar pagesa më të larta ndaj Koncesionarit për shkak të rritjes së taksave dhe ky nen 2.4.5 nuk u njeh asnjë nga këto të drejta kontraktorëve të Koncesionarit.

Koncesionari do t’i dërgojë Autoritetit Kontraktues të gjitha dokumentet që vërtetojnë shumën e të gjitha Kostove të Rritura të Koncesionarit, brenda 3 muajve nga mbyllja e çdo viti kalendarik.

Nëse do të ketë diferenca midis Kostove të Rritura vjetore përfundimtare të Koncesionarit dhe shumës së Kostove të Rritura të Koncesionarit të mbajtura nga Koncesionari gjatë vitit të mëparshëm, Koncesionari do të paguajë diferencën brenda 60 ditëve nga dërgimi i dokumentacionit nga Koncesionari ose do të mbajë pagesat e çdo Takse të ardhshme deri në vlerën e diferencës.

Autoriteti Kontraktues do të sigurojë që autoritetet tatimore dhe/ose doganore përgjegjëse, sipas rastit, të ndërmarrin çdo veprim të nevojshëm për të kryer kompensimin e kostove shtesë kundrejt Taksave të Pagueshme nga Koncesionari përpara ose në datën kur secila nga këto Taksa të Pagueshme bëhet e kërkueshme. Për këtë qëllim, Koncesionari do të dorëzojë deklaratat tatimore përkatëse jo më vonë se tri ditë përpara datës në të cilën pagesa e çdo Takse të Pagueshme bëhet e kërkueshme, por nuk do të kryejë asnjë pagesë dhe do të njoftojë autoritetet përgjegjëse për natyrën dhe shumën e Taksave të Pagueshme që do të kompensohen. Autoriteti përgjegjës do të kryejë kompensimin në librat e kontabilitetit/sistemin e tij informatik dhe do të njoftojë menjëherë Koncesionarin dhe Autoritetin Kontraktues lidhur me këtë. Në rast të dështimit të autoriteteve përgjegjëse për të kryer këto veprime në kohën e duhur, çdo penalitet dhe kamatëvonesë për pagesë të vonuar ose për pagesa të tjera të ngjashme, të cilët do të bëheshin të kërkueshëm për t’u paguar sipas legjislacionit tatimor, nuk do të jenë të pagueshëm nga Koncesionari dhe këto autoritete përgjegjëse do t’i fshijnë ato menjëherë pa qenë e nevojshme që t’i kërkoet Koncesionarit të ndjekë procedurën e apelit administrativ apo gjyqësor. Dispozitat e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” ose çdo ligj tjetër që ka ndryshuar ose zëvendësuar atë, nuk do të zbatohet në lidhje me këto penaltete dhe kamatëvonesa të lindura nga dështimi i autoriteteve tatimore për të kryer kompensimin sipas këtij neni.



Pavarësisht nga sa më lart, Autoriteti Kontraktues do të mbajë të pacenuar Shoqërinë e Projektit dhe Koncesionarin, si dhe do t'i dëmshpërblejë plotësisht ato, nga çdo pretendim i ngritur nga autoritetet përgjegjëse tatimore dhe doganore, sipas rastit, që lindin si rezultat i mospagesës së taksave sipas neneve 2.4.3, 2.4.4 dhe 2.4.5".

2.6 Një nen i ri 2.5.3 do të shtohet pas nenit 2.5.2 të Kontratës së Koncesionit si vijon:

"2.5.3 Në lidhje me taksën/tarifën e transmetimit ndërkuftar, rregullorja e BE-së nr. 838/2010 do të jetë e aplikueshme dhe do të zbatohet për Koncesionarin deri në harmonizimin e plotë të legjislacionit shqiptar me rregulloren në fjalë. Në lidhje me vendosjen në Shqipëri të ndonjë tarifë për transmetimin brenda vendit, Autoriteti Kontraktues do të sigurojë trajtim të barabartë të Koncesionarit me të gjithë prodhuesit apo tregtuesit e tjerë të energjisë në Shqipëri dhe që Koncesionari do të përfitojë trajtimin më të favorshëm të tarifave të transmetimit brenda vendit të vendosura ndaj një operatori specifik në treg, njëlloj sikur ajo tarifë të ishte vendosur në favor të Koncesionarit. Autoriteti Kontraktues do të sigurojë që, në çdo kohë, Kapaciteti i Transferimit Neto maksimal i disponueshëm do të alokohet në të gjithë kufijtë shqiptarë, në bazë të parimeve të tregut, në mënyrë transparente dhe jo diskriminuese, që do të thotë qoftë përmes një ankandi të shprehur ose të nënkuptuar.

2.7 Dy paragrafët e parë të nenit 2.8.5 do të ndryshohen si vijon:

"Për qëllimet e regjimit të TVSH-së të parashikuar në nenet 2.8.1 deri në 2.8.3 më lart, Shoqëria e Projektit mund të emërojë gjithsej deri në 80 (tetëdhjetë) Kontraktorë të Nivelit 1 dhe Kontraktorë të Nivelit 2 (në çdo kohë) dhe do të ketë gjithashtu të drejtë që të zëvendësojë më pas çdo Kontraktor të emëruar të nivelit 1 ose të nivelit 2.

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve autorizohet që të miratojë emërimet e Kontraktorëve të Nivelit 1 ose Kontraktorëve të Nivelit 2 shtesë, përveç tetëdhjetë (80) Kontraktorëve të përmendur më lart nëse kërkohet nga Shoqëria e Projektit, miratim që nuk mund të refuzohet në mënyrë të paarsyeshme.

2.8 Një nen i ri 2.8.9 do të shtohet si vijon:

"Për qëllime të regjimit të TVSH-së të parashikuar në nenin 2.8, importet, shërbimet ose furnizimet brenda vendit në lidhje me Projektin përfshijnë importet, shërbimet dhe furnizimet brenda vendit që lidhen me Infrastrukturën Zëvendësuese.

2.9 Neni 3.3.8 do të ndryshohet si vijon:

"Afatet në nenet 3.3.5 deri në 3.3.7 nuk do të zbatohen për hidrocentralin e Kokel".

2.10 Në nenin 4.1.1. do të shtohet në fund paragrafi që vijon:

"Pavarësisht sa më sipër, Koncesionari nuk do të paguajë Tarifën e Koncesionit sipas këtij neni 4.1.1 "a" dhe "b", për hidrocentralin e Banjës dhe të Moglicës për një periudhë 15-vjeçare duke filluar nga data e lëshimit të Certifikatës së Përfundimit Final të Hidrocentralit të Banjës".

Në nenin 4.1.3, fjalët "lëshimi i Certifikatës së Përfundimit Final në lidhje me realizimin e hidrocentralit të parë" do të zëvendësohet me "viti i parë për të cilin çdo Tarifë Koncesioni bëhet e pagueshme".

2.11 Neni 7.2.2 do të ndryshohet si vijon:

"Koncesionari do të fillojë ndërtimin e:

a) Hidrocentralit të Banjës në Datën e Fillimit të Punimeve të Ndërtimit;

b) Hidrocentralit të Moglicës në kohën e nevojshme për të finalizuar Ndërtimin e Hidrocentralit të Moglicës në përputhje me Nenin 7.2.3;

c) Hidrocentralit të Kokelit, brenda 10 (dhjetë) vjetësh nga përfundimi i Hidrocentralit të Moglicës nëse Koncesionari vendos, në diskrecionin e tij të plotë, të ndërtojë hidrocentralin e Kokelit;

dhe të përfundojë ndërtimin e hidrocentraleve në përputhje me Praktikat e Mira të Industrisë.

2.12 Në nenin 7.2.3, paragrafi i parë, do të ndryshohet si vijon:

"Koncesionari do të ndërtojë:

a) Hidrocentralin e Banjës në mënyrë që të arrihet Përfundimi Paraprak jo më vonë se 54 muaj nga Data e Fillimit të Punimeve të Ndërtimit, datë e cila do të përbëjë një "Datë Grafiku"

b) Hidrocentralin e Moglicës në mënyrë që të arrihet Përfundimi Paraprak jo më vonë se Data e Planifikuar e Përfundimit të Punimeve të Ndërtimit, datë e cila do të përbëjë një "Datë Grafiku"



2.13 Në nenin 7.2.6 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Pika (ii) e nenit 7.2.6 shfuqizohet.

Pas pikës (iii) të nenit 7.2.6 shtohet një paragraf i ri më poshtë:

“Koncesionari do të jetë përgjegjës për ndërtimin me kostot e tij të të gjithë infrastrukturës tjetër që mbulohet nga uji dhe që nuk përfshihet në pikën (i) të nenit 7.2.6, e cila është evidentuar nga Koncesionari në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore dhe organet e tjera përgjegjëse shtetërore. Për të shmangur çdo dyshim, Koncesionari nuk do të rimbursohet për asnjë nga kostot që do të shkaktohen nga financimi, projektimi, planifikimi, ndërtimi dhe dorëzimi i kësaj infrastrukture shtesë”.

Paragrafi i fundit i nenit 7.2.6 shfuqizohet.

2.14 Neni 7.2.7 do të rinumërohet si neni 7.2.8 dhe sa më poshtë vijon do të përbëjë nenin e ri 7.2.7:

“7.2.7

7.2.7.1 Koncesionari do të jetë përgjegjës për punimet e Infrastrukturës Zëvendësuese përfshirë financimin, projektimin, planifikimin, tenderimin, ndërtimin, dhe dorëzimin e Infrastrukturës Zëvendësuese me kusht që Autoriteti Kontraktues të kompensojë plotësisht Koston e Infrastrukturës Zëvendësuese. Në veçanti, Koncesionari:

a) Do të sigurojë mjetet financiare të nevojshme për planifikimin, projektimin dhe ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese, që përcaktohet në nenin 7.2.7.3 këtu më poshtë. Vlerësimi fillestar kostove përkatëse përpara marrjes së ofertave të tenderit, bazuar në projekt-idetë ishte në shumën 49,646,269 euro, siç është përcaktuar më hollësisht në aneksin I bashkëngjitur. Kjo shumë do të përditësohet pas miratimit të propozimit të projektit të detajuar nga enti shtetëror (ARRSH). Kostoja e parashikuar e projekteve përkatëse, e miratuar nga enti shtetëror përkatës (ARRSH) do të shërbejë si limit për procesin e tenderimit, siç përcaktohet në nenin 3 të kësaj Shtese të 3-të. Këto shuma të parashikuara në projektin e detajuar nuk përbëjnë kostot finale të rimbursueshme sipas kësaj Marrëveshjeje dhe do të përditësohen gjatë fazës së ndërtimit të Infrastrukturës Zëvendësuese, me miratimin paraprak të ARRSH-së, siç përcaktohet në paragrafin e dytë të nenit 3.5;

b) Do të sigurojë projektimin e Infrastrukturës Zëvendësuese në përputhje me kërkesat teknike, siç parashikohet në aneksin II bashkëngjitur dhe legjislacionin shqiptar përkatës deri në masën që ky i fundit është i zbatueshëm dhe në përputhje me aneksin II, si dhe të propozojë modifikime të këtyre projekteve ose riprojektme nëse konsiderohen të nevojshme;

c) Do të organizojë tenderë dhe lidhë kontratat për punimet lidhur me planifikimin, projektimin dhe ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese, sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në Marrëveshjen e Infrastrukturës Zëvendësuese bashkëngjitur si aneksi III;

d) Do të organizojë dhe mbikëqyrë punët për planifikimin, projektimin dhe ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese siç parashikohet në Marrëveshjen e Infrastrukturës Zëvendësuese bashkëngjitur si aneksi III dhe legjislacionin shqiptar përkatës deri në masën që ky i fundit është i zbatueshëm dhe në përputhje me aneksin III.

e) Do të dorëzojë tek Autoriteti Kontraktues punimet e përfunduara. Për shmangien e çdo dyshimi, Autoriteti Rrugor shqiptar do të fitojë pronësinë mbi Infrastrukturën Zëvendësuese, përfshirë këtu edhe punën në proces gjatë ndërtimit.

7.2.7.2 Marrëveshja e Infrastrukturës Zëvendësuese do të jetë pjesë integrale e kësaj Kontrate Koncesioni, siç është përcaktuar në aneksin III dhe detyrimet e marra përsipër nga palët e Marrëveshjes së Infrastrukturës Zëvendësuese do të konsiderohen si detyrime të Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit sipas Kontratës së Koncesionit. Pavarësisht kësaj, nëse dispozitat e Marrëveshjes së Infrastrukturës Zëvendësuese bien në kundërshtim me Kontratën e Koncesionit, dispozitat e kësaj të fundit do të kenë përparësi.

7.2.7.3 Koncesionari do të rimbursohet plotësisht për të gjitha shpenzimet e kryera në lidhje me planifikimin, projektimin, tenderimin dhe ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese që vijon: rruga zëvendësuese Banja - Gramsh, Ura e Trashovicës, rruga zëvendësuese Moglicë M15 dhe rruga zëvendësuese Moglice M03, minus 10.550.000 EURO (dhjetë milionë e pesëqind e pesëdhjetë mijë euro) e cila është shuma totale e kompensimit e pagueshme nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues sipas nenit 7.2.6 të



Kontratës së Koncesionit (dhe për të evituar çdo dyshim, shumë që Koncesionari nuk do t'ia paguajë më Autoritetit), (Kostoja e Infrastrukturës Zëvendësuese).

7.2.7.4 Importi ose furnizimet brenda vendit të mallrave (duke përfshirë të gjitha makineritë dhe pajisjet, linjat teknologjike, automjetet, lëndët e para, pjesët e këmbimit dhe çdo mall tjetër) si dhe shërbimet e kryera në çdo rast në lidhje me financimin, projektimin, planifikimin, tenderimin, ndërtimin dhe dorëzimin e Infrastrukturës Zëvendësuese konsiderohen si të lidhura me Projektin për qëllime të Nenit 2.8, pavarësisht nga trajtimi i përcaktuar në rregullat e përgjithshme të TVSH-së, dhe në këtë mënyrë do t'i nënshtrohet regjimit specifik të TVSH-së siç është përshkruar në nenin 2.8 të Kontratës së Koncesionit, duke lejuar Koncesionarin dhe çdo Kontraktor të Nivelit 1 ose Kontraktor të Nivelit 2 që të zbresin TVSH-në e tyre në blerje.

7.2.7.5 Rimbursimi i Kostos së Infrastrukturës Zëvendësuese nga Autoriteti Kontraktues tek Koncesionari do të kryhet si më poshtë:

(a) Autoriteti Kontraktues do t'i paguajë Koncesionarit Koston e Infrastrukturës Zëvendësuese me këste në secilën datë pagese (Datë Pagese) në shuma sipas kështit të pagueshëm (Kësti i Pagueshëm) që aplikohen në Datë-Pagesën përkatëse sipas përcaktimeve në tabelën më poshtë:

Datë pagese	Kësti i pagueshëm
28-shkurt-2015	EUR 8 milionë
28-shkurt-2016	EUR 10 milionë
28-shkurt-2017	EUR 10 milionë
28-shkurt-2018	50% e: Kostos totale të Infrastrukturës Zëvendësuese minus Këstet e Pagueshme të paguara dhe çdo shumë të kompensuar në zbatim të nenit 7.2.7.6
28-shkurt-2019	Shuma e mbetur

Nëse Data Efektive e Shtesës së 3-të nuk ka ndodhur deri më 28 shkurt 2015, atëherë Data e parë e Pagesës do të shtyhet deri në datën e parë të punës pas Datës Efektive të Shtesës së 3-të.

Nëse përpara datës së pagesës, Koncesionari nuk ka dokumentuar në përputhje me nenin 7.2.7.7 se Kostot e Infrastrukturës zëvendësuese të kryera kalojnë shumë përkatëse të Kështit të

Pagueshëm, atëherë Autoriteti Kontraktues do të paguajë në datën e pagesës vetëm shumën e dokumentuar. Pjesa e mbetur e kështit përkatës të pagueshëm do të paguhet brenda tridhjetë (30) ditësh pasi Koncesionari ka dokumentuar që kostot e infrastrukturës zëvendësuese kanë kaluar shumë e Kështit përkatës të Pagueshëm.

b) Autoriteti Kontraktues do të paguajë kamatëvonesë ligjore për pagesën me vonesë për çdo Këst të Pagueshëm të papaguar në datën e pagesës përkatëse në përputhje me normën e interesit dhe dispozitat e ligjit nr. 48/2014, date 24.4.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”.

7.2.7.6 Në rast mospagese të ndonjë Kësti të Pagueshëm nga Autoriteti Kontraktues në secilën Datë Pagese përkatëse, në përputhje me nenin 7.2.7.5 më sipër, dhe që nuk shlyhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi me shkrim i dhënë Autoritetit Kontraktues nga Koncesionari, Koncesionari, përveçse të vazhdojë të paraqesë dhe ekzekutojë pretendimet e tij për pagesën e Kështeve të pagueshëm nga Autoriteti Kontraktues dhe të gjitha mjetet e tjera ligjore të disponueshme për Koncesionarin si pasojë e mos pagesës së ndonjë Kësti të Pagueshëm nga Autoriteti Kontraktues, do të ketë edhe të drejtë të kompensojë Koston e Infrastrukturës Zëvendësuese kundrejt çdo Tarife Koncesionitë pagueshme sipas Nenit 4.1 të Kontratës së Koncesionit si dhe kundrejt çdo dhe të gjitha Taksave të Pagueshme, pra Koncesionari nuk do të paguajë ndonjë Tarifë Koncesioni dhe as ndonjë prej Taksave të Pagueshme deri sa të arrihet rimbursimi i plotë i Kostos së Infrastrukturës Zëvendësuese në kombinim me elementin tjetër të kompensimit sipas tabelës në nenin 7.2.7.5 më sipër. Autoriteti Kontraktues do të garantojë që autoritetet përkatëse tatimore dhe doganore të ndërmarrin çdo veprim të nevojshëm për të zbatuar kompensimin kundrejt Taksave të Pagueshme nga Koncesionari përpara ose në datën kur secila prej Taksave të Pagueshme duhet të paguhet. Për këtë qëllim, Koncesionari do të depozitojë deklaratat tatimore përkatëse jo më vonë se tre ditë përpara se ndonjë prej Taksave të Pagueshme të duhet të paguhet, por nuk do të kryejë ndonjë pagesë dhe do të njoftojë autoritetin kompetent për natyrën



dhe shumën e Taksës së Pagueshme për t'u kompensuar. Autoriteti kompetent do të kryejë kompensimin në librat e kontabilitetit/sistemin kompjuterik të tyre dhe do të njoftojë menjëherë Koncesionarin dhe Autoritetin Kontraktues. Në rast moskryerjeje të këtyre veprimeve në kohë nga autoritetet kompetente, çdo penaltet dhe interes për pagesë të vonuar ose pagesa të tjera të ngjashme që përndryshe do të ishin paguar në afat sipas legjislacionit tatimor, nuk do të jenë të pagueshme nga Koncesionari dhe do të hiqet dorë nga to menjëherë nga autoriteti kompetent në fjalë, pa qenë Koncesionari i detyruar të ndjekë proces administrativ apo gjyqësor apelimi. Dispozitat e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” ose çdo ligj tjetër që e ndryshon ose zëvendëson atë, nuk do të aplikohet në lidhje me këto penaltete dhe interesa të ardhura, si pasojë e moskryerjes së kompensimit sipas kësaj dispozite nga autoritetet tatimore.

7.2.7.7 Në ose para datës 31 janar të çdo viti kalendarik, Koncesionari do t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues të gjithë informacionin, së bashku me dokumentacionin financiar dhe teknik të nevojshëm në mënyrë të arsyeshme për qëllime të konfirmimit të (i) të gjithë Kostos së Infrastrukturës Zëvendësuese të lindur gjatë vitit të kaluar kalendarik dhe (ii) shumën e paguar ose të kompensuar në përputhje me nenet 7.2.7.5 dhe 7.2.7.6 të Kontratës së Koncesionit, siç parashikohet në aneksin V bashkëngjitur. Nëse ndonjë pjesë e Kostove të Infrastrukturës Zëvendësuese nuk është dokumentuar në mënyrë të arsyeshme nga Koncesionari në përputhje me aneksin V, atëherë Autoriteti Kontraktues mund të pezullojë rimbursimin e shpenzimeve vetëm për këtë pjesë, derisa dokumentacioni i nevojshëm të jetë paraqitur nga Koncesionari. Kamatëvonesat ligjore nuk do të jenë të pagueshme për ndonjë pjesë të shpenzimeve, të cilat nuk janë të dokumentuara në mënyrë të arsyeshme, për periudhën derisa kostot në fjalë të dokumentohen.

7.2.7.8 Autoriteti Kontraktues do të sigurojë dhe mundësojë nxjerrjen e të gjitha akteve për sigurimin e të drejtave të servitutit dhe të drejtave të tjera mbi pronën të nevojshme për Koncesionarin ose kontraktorët e tij për të

projektuar, kryer punimet përkatëse inxhinierike të lidhura me, dhe për të ndërtuar Infrastrukturën Zëvendësuese, në kohën e duhur në përputhje me programin kohor për zbatimin e specifikuar në aneksin IV bashkëngjitur.

7.2.7.9 Autoriteti Kontraktues do të sigurojë dhe mundësojë dhënien e të gjitha autorizimeve, pëlqimeve, licencave dhe miratimeve të kërkuara në lidhje me planifikimin, projektimin dhe ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese, në kohën e duhur në përputhje me programin kohor për zbatimin e specifikuar në aneksin IV bashkëngjitur.

7.2.7.10 Nëse Autoriteti Kontraktues dështon që të veprojë në përputhje me programin kohor siç parashikohet me Aneksin IV bashkëngjitur, për arsye që nuk kanë ndodhur për faj të Koncesionarit, ai do të kompensojë dhe dëmshpërblejë Koncesionarin lidhur me çdo dhe të gjitha kostot, humbjet dhe dëmet e tjera që rezultojnë nga kjo mospërmbyllje.

Procesi i kompensimit dhe dëmshpërblimit sipas këtij neni 7.2.7.10 do të jetë si në vijim:

i) Koncesionari do të dërgojë një njoftim tek Autoriteti Kontraktues me detaje për kostot, humbjet dhe dëmet të tjera të pësuar, bashkë me dokumentet mbështetëse;

ii) Autoriteti Kontraktues do të shqyrtojë njoftimin dhe dokumentacionin dhe do të përgjigjet nëse miraton apo kundërshton kërkesën apo pjesë të saj brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit;

iii) Autoriteti Kontraktues do t'i paguajë Koncesionarit shumat e pakundërshtuara brenda një periudhe shtesë prej 30 ditësh;

iv) Nëse ndonjë shumë kundërshtohet, atëherë secila Palë mund të kërkojë zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me parashikimet e nenit 13 të Kontratës së Koncesionit;

v) Nëse pagesa e përcaktuar sipas pikës (iii) ose (iv) më sipër nuk kryhet brenda afatit, atëherë Koncesionari do të ketë të drejtë që të kompensojë çdo Tarifë Koncesionare të pagueshme sipas nenit 4.1 të Kontratës së Koncesionit dhe çdo e të gjitha Taksat e Pagueshme kundrejt shumës së vendosur, në përputhje me parashikimet e nenit 7.2.7.6”.

2.15 Në nenin 7.3.1, do të shtohet shkronja (f) si në vijim:

“(f) nëse fillimi i shfrytëzimit të ndonjë prej hidrocentraleve shtyhet për shkak të vonesës në



realizimin e ndonjë pjese të Infrastrukturave Zëvendësuese, për arsye të tjera nga veprimet me dashje ose mospërmbushja e qëllimshme e Koncesionarit, atëherë Data e Përfundimit të Punimeve të Ndërtimit sipas Grafikut do të shtyhet për një periudhë kohe të njëjtë me vonesën në fjalë;

2.16 Garancia e Kontratës do të zvogëlohet në shumën prej 44 milionë euro. Rrjedhimisht, paragrafët (a), (c), dhe (e) të nenit 7.3.14 të Kontratës së Koncesionit do të ndryshohen si vijon:

Paragrafi (a) i nenit 7.3.14

"(a) Në Datën Efektive të shtesës së 3-të, Koncesionari do t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues një Garanci Kontrate në thelb në formën e përcaktuar në aneksin D (Forma e Garancisë së Kontratës). Vlera fillestare e Garancisë së Kontratës do të jetë 44 milionë EURO dhe në çdo rinovim të mëvonshëm Garancia e Kontratës do të jetë e vlefshme për të paktën një vit.

Brenda 60 ditëve nga njoftimi me shkrim i Koncesionarit tek Autoriteti Kontraktues që Koncesionari ka zgjedhur të ndërtojë Hidrocentralin Kokel, Koncesionari do t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktues një Garanci Kontrate sipas formatit të parashikuar në aneksin D (Formati i Garancisë së Kontratës) për një vlerë 6 milionë euro dhe në çdo rinovim të mëvonshëm Garancia e Kontratës do të jetë e vlefshme për të paktën një vit".

Paragrafi (c) i nenit 7.3.14

"c) Autoriteti Kontraktues pranon se shuma fillestare e Garancisë së Kontratës do të zvogëlohet me:

i) EURO 16 milionë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit Final për Hidrocentralin e Banjës (minus ndonjë shumë që është tërhequr deri në atë kohë për pretendimet lidhur me hidrocentralin e Banjës)

ii) EURO 28 milionë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit Final për Hidrocentralin e Moglicës (minus ndonjë shumë që është tërhequr deri në atë kohë për pretendimet lidhur me Hidrocentralin e Moglicës)".

Paragrafi (e) i nenit 7.3.14

"e) Shuma maksimale që Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë sipas

Garancisë së Kontratës do të jetë EURO 44 milionë".

2.17 Pas paragrafit (d) të nenit 11.3 të Kontratës së Koncesionit do të shtohet një paragraf i ri (e) si më poshtë:

"e) Autoriteti Kontraktues nuk është në gjendje ose nuk arrin të kryejë të gjitha dhe çdo detyrim të tij të përcaktuar në nenet 2.4.5 dhe 7.2.7, shkelje e cila ka nuk është ndrequr 3 (tre) muaj pas njoftimit të shkeljes nga Koncesionari".

Në aneksin A, pjesa A (Kërkesat Teknike Minimale), germa (a) (Projekt-Ideja e Rishikuar dhe Projekti i Detajuar), paragrafi i fundit, fjalët "të paktën tri Hidrocentrale" zëvendësohen me "të paktën dy Hidrocentrale".

3. MOSZBATIMI I RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK

3.1 Për shmangien e çdo dyshimi, rregullat e prokurimit publik të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar apo në ndonjë akt ligjor që mund të ndryshojë ose të zëvendësojë atë, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij ose në zbatim të ndonjë akti ligjor që mund të ndryshojë ose të zëvendësojë atë, nuk do të zbatohen nga Koncesionari në procesin e tenderimit të projektimit, ndërtimit, mbikëqyrjes ose shërbime të tjera ndihmëse në lidhje me Infrastrukturën Zëvendësuese.

3.2 Përzgjedhja e kontraktorëve të angazhuar në procesin e projektimit, ndërtimit, mbikëqyrjes ose shërbime të tjera ndihmëse në lidhje me Infrastrukturën Zëvendësuese do të kryhet nëpërmjet një procedure konkurruese të përcaktuar nga Koncesionari. Projektimi, ndërtimi, mbikëqyrja dhe testimi i Infrastrukturës Zëvendësuese do të kryhet nga subjekte të specializuara dhe të licencuara, në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara në aneksin II.

3.3 Autoriteti Kontraktues do të monitorojë procedurën e tenderimit të Infrastrukturës Zëvendësuese dhe për këtë qëllim do të caktojë 2 (dy) persona të autorizuar të cilët do t'i nënshtrohen detyrimeve të konfidencialitetit dhe mospublikimit të ndonjë informacioni të marrë gjatë procesit të mësipërm, dhe që do të nënshkruajnë një marrëveshje konfidencialiteti dhe mospublikimi të informacionit me përmbajtje që plotëson kërkesat e Koncesionarit.



3.4 Autoriteti Kontraktues dhe/ose çdo Ent tjetër Shtetëror (ARRSH) do të mbikëqyrë ndërtimin, mbikëqyrjen dhe testimin e Infrastrukturës Zëvendësuese nëpërmjet personelit të saj të specializuar.

3.5 Koncesionari do të dorëzojë projektin e detajuar final të propozuar dhe vlerat e përditësuara të parashikimit të kostove për çdo pjesë të Infrastrukturës Zëvendësuese përkatëse kur të jetë e mundur, tek Enti Shtetëror përgjegjës (ARRSH) për miratim, miratim i cili nuk duhet të refuzohet pa arsye. Bazuar në miratimin e projektit të detajuar nga Enti Shtetëror, Koncesionari do të realizojë procesin e tenderimit dhe do të njoftojë Autoritetin Kontraktues për vlerën e negociuar të kontratave përpara se të shpallet fituesi. Miratimi i projektit të detajuar nga Enti Shtetëror si dhe vlerat e kontratave do të shërbejnë si bazë për miratimin nga ana e Autoritetit Kontraktues të vlerës së kontratës fituese.

Nëse vlerat e negociuara të kontratave nuk i tejkalojnë kostot e projektit të detajuar të miratuar nga Enti Shtetëror, atëherë Koncesionari do të lidhë kontrata ndërtimi mbi këtë bazë dhe do të vazhdojë me ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese përkatëse. Për të shmangur çdo dyshim, kontratat e ndërtimit bazohen në sasi dhe nuk janë kontrata me çmim fiks. Çdo punim shtesë mbi volumet e përcaktuara në projektin e detajuar sipas kontratës, duhet të miratohet, në mënyrë progresive me realizimin e projektit, si nga Enti Shtetëror (ARRSH) ashtu edhe nga Koncesionari. Në këtë mënyrë, kostot finale të ndërtimit, të cilat do të përbëjnë shumën për t'u rimbursuar sipas nenit 7.2.7 të Kontratës së Koncesionit, nuk do të konfirmohen përpara se ndërtimi të jetë përfunduar.

Nëse vlerat e kontratave tejkalojnë parashikimin e kostove të projektit të detajuar, atëherë vlerat do të miratohen nga të dyja Palët e Kontratës së Koncesionit dhe Koncesionari do të punojë për rishikimet e projektit, rinegocimet e ofertave të tenderit dhe masa të tjera dhe Palët do të synojnë të bien dakord në mirëbesim për një përditësim të kostos së parashikuar.

3.6 Nëse, pas rinegociimit të ofertave të tenderit, rishikimeve të projektit, dhe masave të tjera, Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari nuk bien dakord mbi vlerësimin e ri të kostove, atëherë

Koncesionari do të paraqesë propozimin e tij final tek Autoriteti Kontraktues për miratim, miratim i cili nuk do të refuzohet në mënyrë të paarsyeshme. Autoriteti Kontraktues do t'i përgjigjet Koncesionarit brenda 10 ditëve pune. Në rast se Autoriteti Kontraktues nuk kthen përgjigje brenda këtij afati, atëherë miratimi do të konsiderohet i dhënë.

Nëse Autoriteti Kontraktues nuk e miraton propozimin final të Koncesionarit, Koncesionari mund t'i dërgojë një njoftim Autoritetit Kontraktues duke i kërkuar që (i) të marrë përsipër përgjegjësinë për ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese dhe (ii) t'i paguajë Koncesionarit të gjitha kostot që ka pësuar Koncesionari në lidhje me planifikimin, projektimin, tenderimin, dhe çdo punë ndërtimore të lidhur me Infrastrukturën Zëvendësuese gjatë asaj kohe.

3.7 Nëse Autoriteti Kontraktues nuk konfirmon që do të marrë përsipër këtë përgjegjësi dhe nuk ia paguan këto kosto Koncesionarit brenda 30 ditëve nga dërgimi i njoftimit, atëherë kontratat e ndërtimit do të konsiderohen të miratuara dhe Koncesionari do të vazhdojë me ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese. Nëse Autoriteti Kontraktues konfirmon që do të marrë përsipër këtë përgjegjësi dhe ia paguan kostot Koncesionarit brenda 30 ditëve në fjalë, atëherë do të zbatohen rregullat si në vijim:

a) Autoriteti Kontraktues do të marrë përsipër përgjegjësinë për të ndërtuar Infrastrukturën Zëvendësuese sipas Kontratës së Koncesionit, bashkë me çdo detyrim që rezulton ose që lidhet me Infrastrukturën Zëvendësuese dhe do të përfundojë Infrastrukturën Zëvendësuese në përputhje me parashikimet e nenit fillestar 7.2.6 të Kontratës së Koncesionit, përfshirë zbatimin e shkronjës (c) të këtij neni;

b) Koncesionari, duke marrë miratimet e nevojshme nga palë të treta, do të transferojë te Autoriteti Kontraktues në gjendjen “siç janë” të gjitha asetet dhe të drejtat e fituara nga Koncesionari në Infrastrukturën Zëvendësuese deri në datën e kërkesës së sipërpërmendur;

c) Të dyja Palët bien dakord që afati për ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese, i përcaktuar në paragrafin e fundit të Nenit 7.2.6 të Kontratës së Koncesionit, i cili është aktualisht tre (3) muaj përpara Datës së njoftuar të realizimit të



Mbushjes me ujë të Ujëmbledhësit (5.2.2016) për Hidrocentralin e Banjës do të shtyhet për 4 (katër) muaj pra më 5.3.2016.

Nëse Data e realizimit të Mbushjes me ujë të Ujëmbledhësit do të shtyhet për më shumë se katër (4) muaj, për çfarëdo arsye të ndryshme nga ndërtimi i Infrastrukturës Zëvendësuese, atëherë afati për përfundimin e Infrastrukturës Zëvendësuese do të shtyhet tek data e cila bie tre (3) muaj përpara Datës së re të realizimit të Mbushjes me ujë të Ujëmbledhësit, siç përcaktohet në Nenin 7.2.6 të Kontratës së Koncesionit.

Të dyja Palët do të diskutojnë dhe bien dakord në mirëbesim për masat që duhet të merren nga Autoriteti Kontraktues në lidhje me ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese ose ndonjë pjesë të saj, duke marrë në konsideratë nevojat e Koncesionarit për ndërtimin e çdo pjese të Infrastrukturës Zëvendësuese.

d) Autoriteti Kontraktues do të jetë përgjegjës ndaj Koncesionarit për të gjitha kostot, dëmet dhe humbjet që lindin nga çfarëdo mospërfundim i Infrastrukturës Zëvendësuese në afatet e përcaktuara;

e) Autoriteti Kontraktues do të mbajë të pacenuar dhe do të dëmshpërblejë Koncesionarin për të gjitha pretendimet, dëmet dhe humbjet që vijnë prej furnitorëve dhe kontraktorëve të tjerë ose çdo palë tjetër të tretë në lidhje me planifikimin, projektimin dhe tenderimin e Infrastrukturës Zëvendësuese ose lidhen me Infrastrukturën Zëvendësuese; dhe

f) Procesi i kompensimit dhe dëmshpërblimit sipas shkronjës “d” dhe “e” këtu më sipër, do të jetë si ne vijim:

i) Koncesionari do të dërgojë një njoftim tek Autoriteti Kontraktues me detaje për kostot, humbjet dhe dëme të tjera, bashkë me dokumentet mbështetës;

ii) Autoriteti Kontraktues do të shqyrtojë njoftimin dhe dokumentacionin dhe do të përgjigjet nëse miraton apo kundërshton kërkesën apo pjesë të saj brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit;

iii) Autoriteti Kontraktues do t'i paguajë Koncesionarit shumat e pakundërshtuara brenda një periudhe shtesë prej 30 ditësh;

iv) Nëse ndonjë shumë kundërshtohet, atëherë secila Palë mund të kërkojë zgjidhjen e

mosmarrëveshjes në përputhje me parashikimet e nenit 13 të Kontratës së Koncesionit;

v) Nëse pagesa e përcaktuar sipas pikës (iii) ose (iv) më sipër nuk kryhet brenda afatit, atëherë Koncesionari do të ketë të drejtë që të kompensojë çdo Tarife Koncesionare të pagueshme sipas nenit 4.1 të Kontratës së Koncesionit dhe çdo e të gjitha Taksat e Pagueshme kundrejt shumës së vendosur, në përputhje me parashikimet e nenit 7.2.7.6”.

3.8 Me konfirmimin nga Autoriteti Kontraktues që do të marrë përsipër përgjegjësinë për ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese dhe me pagesën ndaj Koncesionarit të kostove të pësura siç përcaktohet më lart, çdo e drejtë, titull apo interes që i është dhënë apo është marrë nga Koncesionari në lidhje me Infrastrukturën Zëvendësuese do t'i transferohet menjëherë Autoritetit Kontraktues.

3.9 Dispozitat e Shtesës së 3-të nuk do të zbatohen më dhe dispozitat origjinale të Kontratës së Koncesionit, siç janë ndryshuar me Shtesën e 1-rë dhe/ose Shtesën e 2-të, do të bëhen të zbatueshme, me përjashtim të neneve të mëposhtme të shtesës së 3-të: Neni 2.1 (vetëm përkufizimet që vijnë “Autoriteti Kontraktues”, “Transferimi i Kapacitetit Neto” dhe “Taksat e Pagueshme”), neni 2.3, neni 2.6, neni 3.7, neni 3.8 dhe neni 3.9, të cilët do të vazhdojnë të mbeten në fuqi me efekt të plotë.

3.10 ARRSH do të monitorojë dhe kontrollojë projektin dhe ndërtimin e aktiviteteve në lidhje me Infrastrukturën Zëvendësuese deri në momentin që aktivitetet e përfunduara t'i kalojnë ARRSH-së. Në të njëjtën kohë, çdo ndryshim/devijim nga projekti i miratuar dhe nga pjesa teknike e dokumenteve të tenderit, duke përfshirë termat e referencës dhe specifikimet teknike do t'i nënshtrohen miratimit paraprak të ARRSH-së.

4. MIRATIMI NGA KOMISIONI I NDIHMËS SHTETËRORE

Autoriteti Kontraktues konfirmon se Komisioni i Ndihmës Shtetërore shqiptare ka miratuar afatet dhe kushtet e Kontratës së Koncesionit dhe këtë Shtesë të 3-të.

5. SHKELJA THELBËSORE

Çdo veprim ose mosveprim i çdo Enti Shtetëror, në shkeljet e neneve 2.3, 2.4, 2.5, 2.6, 2.10, 2.14 dhe 3 të kësaj Shtesë të 3-të, ose çdo dështim tjetër nga ana e një Enti Shtetëror për vënien në funksionim dhe zbatimin e kësaj shtesë



të 3-të, përbën një shkelje thelbësore nga Autoriteti Kontraktues i një detyrimi thelbësor të Kontratës së Koncesionit.

6. MIRATIMI NGA KËSHILLI I MINISTRAVE DHE RATIFIKIMI NGA PARLAMENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

6.1 Palët pranojnë se shtesa e 3-të do të hyjë në fuqi dhe do të ketë efekt të plotë në datën më të vonshme prej (i) nënshkrimit të saj nga Palët; (ii) datës së miratimit të saj nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë; (iii) 15 ditë pas datës së publikimit të ratifikimit të shtesës së 3-të nga Parlamenti shqiptar në Fletoren Zyrtare (Fletorja Zyrtare shqiptare) (Data Efektive e Shtesës së 3-të).

6.2 Duke ratifikuar këtë Marrëveshje, Parlamenti i Republikës së Shqipërisë autorizon Autoritetin Kontraktues për të vepruar dhe lidhur këtë Marrëveshje për llogari të Republikës së Shqipërisë e cila do të bëhet në këtë mënyrë Palë e kësaj Marrëveshjeje.

7. TË NDRYSHME

7.1 Palët bien dakord që dispozitat e përcaktuara në nenet 14.2, 14.4 deri në 14.6, 14.8 dhe 14.10 deri në 14.16 të Kontratës së Koncesionit do të zbatohen *mutatis mutandis* ndaj shtesës së 3-të. Palët më tej bien dakord që dispozitat e arbitrazhit të përcaktuara në nenet 13.3.2 deri në 13.3.4 do të zbatohen gjithashtu ndaj shtesës së 3-të.

7.2 Ministri i Financave dhe Ministri i Energjisë dhe Industrisë do të miratojnë një udhëzim të përbashkët për zbatimin e dispozitave që lidhen me tatimet të kësaj shtese të 3-të, brenda një kohe të arsyeshme.

Në dëshmi të sa më sipër, shtesa e 3-të është nënshkruar nga përfaqësues të palëve të autorizuar në mënyrë të rregullt në ditën, muajin dhe vitin e përmendur më lart.

MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRIËS SË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nga: _____
Emri: _____
Titulli: _____

STATKRAFT AS

Nga: _____
Emri: _____
Titulli: _____

DEVOLL HYDROPOWER SHA

Nga: _____
Emri: _____
Titulli: _____

ANEKSET

I) Aneksi I – Parashikimi i kostove bazuar në projektet fillestare sipas nenit të ri 7.2.7.1(a) të Kontratës së Koncesionit.

II) Aneksi II – Kërkesat teknike për projektimin e Infrastrukturës Zëvendësuese sipas Nenit të ri 7.2.7.1(b) të Kontratës së Koncesionit.

III) Aneksi III – Marrëveshja e datës 14.02.2014 në lidhje me “Projektin, tenderin e Infrastrukturës Zëvendësuese (rrugë dhe ura) dhe ndërtimin e infrastrukturës zëvendësuese Moglicë rruga M-15” parashikuar nga neni i ri 7.2.7.1 (c) dhe (d) dhe neni 7.2.7.2.

IV) Aneksi IV – Programi kohor për zbatimin e veprimeve sipas neneve të reja 7.2.7.8 dhe 7.2.7.9 të Kontratës së Koncesionit.

V) Aneksi V – Informacioni/dokumentacioni i kërkuar sipas nenit 7.2.7.7 të Kontratës së Koncesionit

LIGJ

Nr. 8/2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9723, DATË 3.5.2007, “PËR QENDRËN KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT”, TË NDRYSHUAR¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

¹ Ky ligj është përafuar pjesërisht me direktivën 2009/101/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 16 shtator 2009, "Për koordinimin e masave, të cilat, për qëllime të mbrojtjes së interesave të anëtarëve dhe të palëve të treta, duhet të zbatohen nga shoqëritë e shteteve anëtare, në kuptimin e paragrafit të dytë të nenit 48, të Traktatit, dhe me qëllim për t'i bërë këto masa ekuivalente", të ndryshuar". Numri CELEX: 32009L0101, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 258, datë 1.10.2009, faqe 11-19.



Neni 1

Kudo në ligj termat e mëposhtëm ndryshohen si më poshtë:

- a) “Subjekti tregtar” zëvendësohet me fjalën “subjekti”.
- b) “Bashki e komuna” zëvendësohet me fjalët “njësi të qeverisjes vendore”.
- c) “Shoqëri anonime” zëvendësohet me fjalët “shoqëri aksionare”.
- ç) “Veprimtari ekonomike tregtare” zëvendësohet me fjalën “veprimtari”.

Neni 2

Në nenin 2 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. “Regjistri” është regjistri tregtar, në të cilin regjistrohen subjektet, sipas këtij ligji.”.

2. Pas pikës 11 shtohen pikat 12, 13, 14, 15 dhe 16 me këtë përmbajtje:

“12. “Subjekt” janë subjektet tregtare dhe subjektet e tjera, të cilat, pa pasur cilësinë e tregtarit, kanë detyrimin e regjistrimit, sipas këtij ligji.

13. “Subjekt tregtar” është personi fizik, sipas kuptimit të Kodit Civil, që ka cilësinë e tregtarit, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi, shoqëritë tregtare dhe degët e shoqërive të huaja.

14. “Mjet elektronik” është çdo mjet, me anë të të cilit mundësohen dërgimi fillestar i informacionit e marrja e tij nga marrësi i përcaktuar me anë të pajisjeve elektronike për përpunimin (duke përfshirë ngjeshjen shifrore) dhe ruajtja e të dhënave, tërësisht të transmetuara, të përcjella apo të marra përmes kabllove, valëve radio, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike.

15. “Sporteli elektronik” është portali elektronik i QKR-së, i aksesueshëm nëpërmjet faqes zyrtare në internet, e hapur nga QKR-ja, ku mundësohet ofrimi i shërbimit për publikun në distancë, duke komunikuar drejtpërdrejt me sistemin qendror të QKR-së, nëpërmjet mjeteve elektronike.

16. “Veprimtari” është veprimtaria e pavarur ekonomike, profesionale apo tregtare, e ushtruar në mënyrë të vazhdueshme nga subjektet.”.

Neni 3

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “dh” ndryshohet si më poshtë:

“dh) informon dhe këshillon për procedurat e regjistrimit.”.

2. Shkronja “e” shfuqizohet.

Neni 4

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 5

Organizimi dhe sportelet

1. QKR-ja ka juridiksion në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe është institucioni i vetëm që ofron shërbim ndaj publikut, sipas parashikimeve të këtij ligji, nëpërmjet sportelit të saj qendror, sporteleve të shërbimit pranë njësive të qeverisjes vendore apo organizatave të tjera, me të cilat lidh marrëveshje bashkëpunimi, si dhe sporteleve të shërbimit në territor, në kuadër të strukturës së saj.

2. QKR-ja ofron shërbim në territor, nëpërmjet sporteleve të shërbimit pranë njësive të qeverisjes vendore, si funksion i deleguar, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjit për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore. QKR-ja lidh marrëveshje bashkëpunimi me njësinë e qeverisjes vendore, ku përcaktohen kushtet e ofrimit të shërbimit dhe treguesit kryesorë të performancës, kualifikimet dhe kriteret e posaçme profesionale të nëpunësve të sportelit, si dhe trajnimet e detyrueshme për nëpunësit.

3. QKR-ja mund të kryejë funksionet e saj, sipas këtij ligji, edhe nëpërmjet hapjes së sporteleve të shërbimit, në bashkëpunim dhe pranë Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë dhe/ose dhomave të tregtisë, rregulluar sipas legjislacionit përkatës. Hapja e këtyre sporteleve bëhet në marrëveshje me këto organizata, të cilave u delegohen funksionet e sportelit të QKR-së, në përputhje me kushtet e këtij ligji dhe të marrëveshjes së bashkëpunimit.

4. Numri dhe vendndodhja e sporteleve të shërbimit pranë njësive të qeverisjes vendore apo organizatave të tjera të përcaktuara në pikën 3, të këtij neni, miratohet nga ministri me propozim të titullarit të QKR-së, në bazë të planifikimit të nevojës për hapjen e sporteleve të shërbimit në territor dhe ngarkesës së mjaftueshme të veprimeve në sportele.



5. Në rast se njësia përkatëse e qeverisjes vendore apo organizata, me të cilat QKR-ja ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi, sipas këtij neni, nuk ofrojnë shërbimin e sportelit në përputhje me parashikimet e këtij ligji apo me parashikimet e marrëveshjes së lidhur me QKR, titullari i QKR-së ka të drejtë t'i propozojë ministrit mbylljen e sportelit përkatës.

6. Në rastet e parashikuara nga pika 5 e këtij neni, QKR-ja, në bazë të vlerësimit paraprak të nevojës së hapjes së sporteleve në territor dhe të ngarkesës së mjaftueshme të veprimeve në sportelin përkatës, mund të zëvendësojë sportelin e mbyllur, duke hapur një sportel shërbimi, në kuadër të strukturës së saj, në përputhje me parashikimet e nenit 7 të këtij ligji.

7. QKR-ja mund të kryejë funksionet e saj, sipas këtij ligji, edhe nëpërmjet hapjes së një sporteli elektronik. Kryerja e veprimeve, sipas këtij ligji, nëpërmjet sportelit elektronik të QKR-së dhe lëshimi i njoftimeve dhe akteve të QKR-së bëhet në përputhje me parashikimet e kreut VI të këtij ligji.

8. Të gjitha sportelet e shërbimit lidhen online me sistemin qendror të QKR-së.”.

Neni 5

Neni 5/1 shfuqizohet.

Neni 6

Në nenin 6, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Titullari i QKR-së ushtron kompetencat drejtuese metodologjike dhe nxjerr, në lidhje me zbatimin e procedurave që ndiqen, sipas këtij ligji, urdhra e udhëzime të detyrueshme për të gjitha sportelet e shërbimit.”.

Neni 7

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 8

Statusi i titullarit

Titullari i QKR-së është nëpunës civil, i cili duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme që parashikon legjislacioni për nëpunësin civil dhe të ketë arsim të lartë në shkencat juridike apo ekonomike.”.

Neni 8

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 9

Nëpunësit dhe punonjësit administrativë

1. Nëpunësit e QKR-së janë nëpunës civilë dhe për ta zbatohen dispozitat e legjislacionit për nëpunësin civil.

2. Marrëdhëniet e punës të punonjësve administrativë të QKR-së rregullohen sipas Kodit të Punës.”.

Neni 9

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 10

Nëpunësit e sporteleve të shërbimit

“1. Nëpunësit e sporteleve të shërbimit, të hapura nga QKR-ja, sipas pikës 2, të nenit 5, të këtij ligji, janë nëpunës të njësisë përkatëse të qeverisjes vendore.

2. Nëpunësit e sporteleve të shërbimit, të hapura nga QKR-ja, sipas pikës 3, të nenit 5, të këtij ligji, janë punonjës të organizatës përkatëse, me të cilën QKR-ja ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.

3. Në rastet kur QKR-ja hap sportele shërbimi sipas pikës 6, të nenit 5, të këtij ligji, nëpunësit e sportelit janë nëpunës të QKR-së, dhe trajtohen në përputhje me parashikimet e nenit 9 të këtij ligji.

4. Me qëllim njësimin e shërbimit që i ofrohet publikut në të gjitha sportelet, nëpunësit e sporteleve të shërbimit duhet të plotësojnë të njëjtat kritere të posaçme profesionale që i zbatohen nëpunësve të sportelit qendror të QKR-së. QKR-ja siguron për nëpunësit e sporteleve të shërbimit të njëjtin trajnim që zbatohet nga QKR-ja për nëpunësit e sportelit qendror të QKR-së.”.

Neni 10

Në nenin 11, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Niveli i pagave dhe i shpërbërimit, si dhe numri i nëpunësve në sportelet, sipas pikave 1 dhe 2, të nenit 10, përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi nga organet kompetente të njësisë të qeverisjes vendore apo të organizatave,



me të cilat QKR-ja ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi, në cilësinë e punëdhënësit.”.

Neni 11

Në nenin 12, pikat 3, 4, 5 dhe 6 ndryshohen si më poshtë:

“3. Buxheti i QKR-së përbëhet nga të ardhurat, që realizohen sipas këtij ligji nga të gjitha sportelet e shërbimit dhe nga të gjitha shpenzimet eQKR-së, përfshirë fondet për shpenzime operative dhe kapitale për sportelet e shërbimit që hapen pranë dhe në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore.

4. Fondet për shpenzime operative për çdo sportel të hapur pranë dhe në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore janë fonde të kushtëzuara dhe përcaktohen në buxhetin e QKR-së, bazuar në kritere të drejta e objektive, në përputhje me vlerësimin paraprak të ngarkesës operative të çdo sporteli dhe të treguesve të cilësisë së shërbimit. Këto fonde u jepen njërive të qeverisjes vendore përkatëse në formën e një shume totale.

5. Shpenzimet për hapjen, funksionimin dhe mirëmbajtjen e sporteleve të hapura pranë dhe në bashkëpunim me organizatat, sipas pikës 3, të nenit 5, me përjashtim të fondeve për kryerjen e trajnimeve për nëpunësit e sportelit, që përballohen nga QKR-ja, mbulohen nga organizata përkatëse, me të cilat QKR-ja lidh marrëveshje bashkëpunimi, dhe nuk janë pjesë e buxhetit të QKR-së.

6. Njësia e qeverisjes vendore apo organizata tjetër, me të cilën QKR-ja lidh marrëveshje bashkëpunimi, në përputhje me objektivat e vet, mund të parashikojë dhe të kryejë shpenzime operative ose kapitale shtesë për përmirësimin e shërbimeve në sportelin dytësor përkatës.”.

Neni 12

Në nenin 18, pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

“1. Regjistri është një bazë të dhënash unike, e ndarë në dosje të veçanta elektronike për secilin subjekt që ka detyrimin e regjistrimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Regjistri mbahet në format elektronik. Të gjitha të dhënat, aplikimet dhe dokumentet

shoqëruese, të paraqitura në format shkresor apo në format elektronik, sipas këtij ligji do të regjistrohen nga QKR-ja në format elektronik në dosjen e subjektit në regjistrin. Të gjitha të dhënat, aplikimet dhe dokumentet shoqëruese:

a) të paraqitura nga aplikantët në format elektronik, sipas këtij ligji, ruhen dhe arkivohen nga QKR-ja vetëm në format elektronik;

b) të paraqitura në format shkresor, sipas këtij ligji, konvertohen dhe ruhen nga QKR-ja në format elektronik. QKR-ja nuk ka detyrim të mbajë e të arkivojë aplikimet dhe dokumentet shoqëruese të paraqitura në format shkresor.”.

Neni 13

Në nenin 20 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Ministri, me propozimin e titullarit të QKR-së, miraton formularët e aplikimit, përmbajtjen e rubrikave të tyre dhe listën e dokumenteve shoqëruese për çdo regjistrim, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.”.

2. Pika 3 shfuqizohet.

Neni 14

Neni 22 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 22

Detyrimi për regjistrim

1. Subjektet që detyrohen të regjistrohen janë:

a) subjektet tregtare;

b) shoqëritë e thjeshta, sipas dispozitave të Kodit Civil;

c) personat fizikë, sipas kuptimit të Kodit Civil, që nuk kanë cilësinë e tregtarit, që ushtrojnë veprimtari ekonomike apo një profesion të pavarur;

ç) zyrat e përfaqësimit të shoqërive shqiptare dhe të shoqërive të huaja;

d) shoqëritë dhe unionet e kursim-kreditit;

dh) shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë;

e) çdo subjekt tjetër, i cili me ligj detyrohet të regjistrohet pranë QKR-së.

2. Përveçse kur një ligj i posaçëm parashikon ndryshe, nuk detyrohen të regjistrohen në regjistrin personat fizikë, në kuptimin e Kodit Civil, të përcaktuar me urdhër të përbashkët të ministrit dhe të Ministrisë të Financave, që



veprojnë si punëdhënës apo të vetëpunësuar në fusha të posaçme apo që ushtrojnë një veprimtari me vëllim të vogël qarkullimi.

3. Subjektet, përveç kur parashikohet ndryshe nga ligje të posaçme, aplikojnë për regjistrim fillestar si më poshtë:

a) personat fizikë, shoqëritë e thjeshta dhe degët apo zyrat e përfaqësimit, përpara datës së nisjes efektive të veprimtarisë;

b) personat juridikë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e themelimit, por, në çdo rast, përpara datës së nisjes efektive të veprimtarisë.

4. Aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë bëhen brenda 30 ditëve kalendarike nga data e vendimit përkatës, por, në çdo rast, përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend.

5. Për regjistrimet e tjera të detyrueshme, përveç rasteve kur ky ligj përcakton ndryshe, aplikimi bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e ngjarjes së rrethanës faktike dhe/ose e hartimit të aktit të detyrueshëm për t'u regjistruar.”.

Neni 15

Në nenin 23, pas pikës 3shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Emri i subjekteve tregtare regjistrohet së bashku me shtojcat që kërkohen, sipas legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”.

Neni 16

Në nenin 24, pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Verifikimi paraprak nëse një emër mund të regjistrohet ose jo, si dhe rezervimi paraprak i emrit nuk përbën kusht për regjistrimin fillestar apo për ndryshimin e emrit të regjistruar.”.

Neni 17

Në nenin 26 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 3, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“3. Aplikimi për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare bëhet bashkërisht nga të gjithë themeluesit apo nga çdo person i autorizuar prej tyre.”.

Faqe | 1448

2. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Për subjektet e tjera që kanë detyrimin e regjistrimit, sipas shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 22, të këtij ligji, aplikimi për regjistrim fillestar bëhet nga personat e përcaktuar, në përputhje me ligjet përkatëse, ose nga çdo person i autorizuar prej tyre.”.

Neni 18

Në nenin 27, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Dokumentet shoqëruese duhet të dorëzohen në origjinal ose në kopje të panjësura me origjinalin dhe të jenë hartuar sipas formaliteteve të përcaktuara nga legjislacioni përkatës apo nga dispozitat e këtij ligji. Dokumentet shoqëruese mund të dorëzohen edhe në format elektronik, sipas parashikimeve të kreut VI. Dorëzimi i dokumentit shoqërues pranë sporteleve të shërbimit në kopje të panjësuar apo në format elektronik bëhet nën përgjegjësinë e plotë të personit që e paraqet atë, i cili, nëpërmjet aktit të dorëzimit, konfirmon njësinë e kopjes apo të dokumentit në format elektronik me origjinalin.”.

Neni 19

Neni 35 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 35

Për regjistrimin fillestar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, përveç sa parashikohet në nenin 32, të këtij ligji, është i detyrueshëm edhe njoftimi i vlerës së përgjithshme të kapitalit të nënshkruar, ndarja e kapitalit në një numër kuotash të barabartë me numrin e ortakëve, vlera dhe lloji i kontributit të secilit ortak, pjesa që kuota e secilit ortak zë në kapital, si dhe informacioni nëse kontributet e nënshkruara të kapitalit janë paguar ose jo.”.

Neni 20

Neni 40 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 40

Subjektet e tjera

Nëse një subjekt ka detyrimin e regjistrimit, sipas shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 22, të këtij ligji, atëherë mënyra e aplikimit për



regjistrimin fillestar dhe të dhënat e detyrueshme për t'u regjistruar nga këto subjekte, sipas seksionit IV, të këtij ligji, përcaktohen nga ligji i posaçëm.”.

Neni 21

Në nenin 43, pika 3, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecuresë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme;”.

2. Në shkronjën “ç”, fjalët “pushimin e veprimtarisë ekonomike tregtare” hiqen.

Neni 22

Në nenin 44, shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) vendimet e organeve drejtuese të subjektit, si vendimet e pezullimit të veprimtarisë apo vendimet e tjera të ndryshme nga vendimet e detyrueshme për regjistrim;”.

Neni 23

Neni 45 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 45

Regjistrimet me vendim gjyqësor

1. QKR-ja regjistron në regjister dhe publikon, kryesisht ose me kërkesë nga çdo person i interesuar, vendimet gjyqësore për të dhënat e regjistruara ose veprimtarinë e subjektit.

2. Kërkesës për regjistrime nga personat e interesuar i bashkëlidhet vendimi përkatës. Regjistrimi kryhet brenda afatit njëditor nga dita kur QKR-së i njoftohet vendimi përkatës ose nga data e paraqitjes së kërkesës së palës së interesuar.”.

Neni 24

Neni 46 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 46

Regjistrimi i pasqyrave financiare

1. Subjektet, që kanë detyrimin e hartimit të dokumenteve, sipas shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 43, të këtij ligji, dhe që nuk i kanë depozituar më parë, në përputhje me afatin e parashikuar në pikën 5, të nenit 22, të këtij ligji, detyrohen në çdo

rast t'i depozitojnë këto dokumente jo më vonë se 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar.

2. Nëse një subjekt nuk përmbush detyrimin, sipas këtij neni, atëherë QKR-ja, së bashku me zbatimin e sanksionit të parashikuar në pikën 3, të nenit 74, të këtij ligji, vepron në përputhje me parashikimet e shkronjës “ë”, të nenit 54, të këtij ligji.”.

Neni 25

Neni 47 shfuqizohet.

Neni 26

Në nenin 49 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Për personat fizikë dhe për subjektet e tjera, në rastet kur ligji nuk parashikon procedura likuidimi në lidhje me to, çregjistrimi në mënyrë vullnetare kryhet nëpërmjet aplikimit për çregjistrim.”.

2. Në paragrafin e dytë, fjalët “për shoqëritë e thjeshta” zëvendësohen me fjalët “për shoqëritë e thjeshta dhe për subjektet e tjera, për të cilat ligji parashikon procedura likuidimi”.

Neni 27

Neni 51 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 51

Çregjistrimi me vendim gjyqësor

Subjekti mund të çregjistrohet në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë që vendos se subjekti prishet, mbaron apo nuk mund të ushtrojë më veprimtari.

QKR-ja çregjistron kryesisht subjektin në bazë të vendimit gjyqësor përkatës, me anë të të cilit vendoset çregjistrimi i subjektit në vijim të ndjekjes së procedurave të likuidimit në rrugë gjyqësore, në rastet kur ligji parashikon procedura likuidimi për këto subjekte, ose në vijim të ndjekjes së procedurave të falimentimit apo të procedurave të tjera që mund të kërkojnë sipas ligjit.”.

Neni 28

Në nenin 54 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shkronja “ë” ndryshohet si më poshtë:

“ë) faktin nëse aplikuesi ka shlyer sanksionet administrative të dhëna dhe ka kryer regjistrimet e kërkuara sipas nenit 46.”.



2. Në pikën 2, pas fjalëve “që i bashkëlidhen aplikimit për regjistrim” shtohen fjalët “apo përputhshmërinë e përmbajtjes së tyre me kërkesat e ligjit në fuqi”.

Neni 29

Në nenin 56, paragrafi i parë, ndryshohet si më poshtë:

“Në rastet kur pas verifikimeve të parashikuara në nenin 54, të këtij ligji, rezulton se nuk janë përmbushur kushtet për regjistrim, nuk janë paguar tarifat përkatëse të regjistrimit, ka sanksione administrative të papaguara apo nuk janë kryer regjistrimet e kërkuara, sipas nenit 46, QKR-ja pezullon aplikimin dhe e njofton aplikuesin me shkrim për shkakun e saktë të pezullimit, duke i dhënë një afat prej 21 ditësh kalendarike për plotësimin ose ndreqjen e elementeve që pengojnë regjistrimin. Njoftimi i shkakut të pezullimit bëhet nëpërmjet një formulari standard të QKR-së.”.

Neni 30

Në nenin 59 bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1, fjalët “autoriteteve tatimore” zëvendësohen me fjalët “administratës tatimore, qendrore dhe vendore,”.

2. Pas pikës 2 shtohen pikat 3 dhe 4 me këtë përmbajtje:

3. Me përjashtim të rasteve kur ligji shprehimisht kushtëzon nisjen e veprimtarisë përkatëse me marrjen e një lejeje, licence apo autorizimi, subjekti i pajisur nga QKR-ja me certifikatën e regjistrimit fillestar ka të drejtë të nisë menjëherë veprimtarinë e tij.

4. Me përjashtim të rasteve kur ligji shprehimisht kushtëzon nisjen e veprimtarisë përkatëse me marrjen e një lejeje, licence apo autorizimi, asnjë autoritet publik nuk mund ta pengojë subjektin të nisë veprimtarinë, menjëherë pasi është pajisur nga QKR-ja me certifikatën e regjistrimit fillestar dhe as ta penalizojë atë, në asnjë formë, për shkak të kërkesave për kryerjen paraprakisht të deklarimeve, regjistrimeve, certifikimeve apo të ndonjë veprimi tjetër, që mund të kërkohej, sipas praktikës administrative apo kuadrit ligjor.

Autoriteti publik, që pengon nisjen e veprimtarisë së subjektit, sipas këtij neni, përgjigjet sipas ligjit për dëmin jashtë kontraktor të administratës publike.”.

Neni 31

Neni 66 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 66

Kërkimet në bazën e të dhënave

Çdo person i interesuar mund të kryejë, sipas këtij ligji, pa pagesë, pranë çdo sporteli shërbimi, kërkime në bazën e të dhënave elektronike për çdo të dhënë të regjistruar, me përjashtim të adresës së banimit të individëve.”.

Neni 32

Në nenin 67, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. QKR-ja konfirmon të dhënat e regjistruara nga subjektet, sipas këtij ligji, nëpërmjet lëshimit të ekstrakteve në format shkresor apo elektronik, sipas këtij ligji. Çdo person, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse, ka të drejtë të marrë pa pengesa, në format shkresor apo elektronik, sipas dëshirës, ekstrakte për të dhënat e regjistruara të çdo subjekti, si dhe kopje të dokumenteve shoqëruese, të depozituara në regjistër.”.

Neni 33

Neni 68 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 68

Vërtetimi i ekstrakteve dhe i dokumenteve shoqëruese

1. Ekstraktet dhe kopjet e dokumenteve shoqëruese në format shkresor, si rregull, lëshohen nga QKR-ja, si kopje e vërtetuar e të dhënave të regjistruara apo të dokumenteve shoqëruese përkatëse, përveç rastit kur personi i interesuar heq dorë nga marrja e këtij vërtetimi.

2. Ekstraktet dhe kopjet e dokumenteve shoqëruese në format elektronik, si rregull, lëshohen nga QKR-ja si kopje e pavërtetuar e të dhënave të regjistruara apo të dokumenteve shoqëruese përkatëse, përveç rastit kur personi i interesuar shprehimisht kërkon ta marrë këtë vërtetim.”.



Neni 34

Kreu VI ndryshohet dhe zëvendësohet me këtë përmbajtje:

**“KREU VI
SPORTELI ELEKTRONIK**

Neni 70

Veprimet pranë sportelit elektronik

1. Çdo individ, pasi të jetë identifikuar elektronikisht, ka të drejtë që, në cilësinë e aplikantit apo të personit të autorizuar, të aplikojë apo të kryejë pranë sportelit elektronik çdo regjistrim apo veprim tjetër, sipas këtij ligji, përfshirë këtu procedurat e ankimit administrativ, dhe të marrë nga QKR-ja nëpërmjet këtij sporteli të gjitha aktet përkatëse të parashikuara nga ky ligj.

2. Çdo individ, pa qenë i detyruar të identifikohet elektronikisht, ka të drejtë të kryejë pranë sportelit elektronik kërkime elektronike në regjistër, të marrë ekstrakte, si dhe kopje të dokumenteve shoqërues në format elektronik apo të kryejë veprime të tjera, për të cilat identifikimi i personit, kryerja e pagesës së një tarife nëpërmjet mjeteve elektronike, nuk kërkohet sipas këtij ligji.

Neni 70/1

Identifikimi elektronik

Veprimet pranë sportelit elektronik të QKR-së, për të cilat ky ligj kërkon identifikimin elektronik, kryhen nëpërmjet mjeteve elektronike që garantojnë autenticitetin e origjinës dhe pacenueshmërinë e përmbajtjes së dokumenteve në format elektronik, të paktën nëpërmjet nënshkrimit elektronik të avancuar, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nënshkrimin elektronik.

Neni 70/2

Kushtet procedurale dhe teknike

Ministri përcakton kushtet, afatet dhe procedurat për ofrimin shërbimeve nga QKR-ja, sipas këtij ligji, nëpërmjet sportelit elektronik, kushtet dhe mënyrat e pajisjes së individëve me të drejtat përkatëse të aksesit elektronik, procedurat për ndryshimin e tyre, kushtet e sigurisë dhe të ruajtjes së komunikimeve elektronike, mënyrat e vërtetimit të dokumenteve elektronike, të lëshuara nga QKR-ja, të kërkesave e teknologjisë së

zbatueshme për realizmin e tyre, sipas këtij kreu, si dhe procedurat e njoftimit publike, të realizuara nga QKR-ja për rastet e remonteve të planifikuara apo të incidenteve teknike të sportelit elektronik, si dhe për njoftimin e rasteve të ndërhyrjeve të paautorizuara.”.

Neni 35

Në nenin 72, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Ndaj aktit të titullarit të QKR-së apo mosveprimit të tij mund të bëhet ankim drejtpërdrejt në gjykatë, sipas legjislacionit që rregullon zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative.”.

Neni 36

Në nenin 74 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Gjoha vendoset nga titullari i QKR-së, vendimi i të cilit ankimohet drejtpërdrejt në gjykatën administrative.”.

2. Pika 5 shfuqizohet.

Neni 37

Në nenin 75, fjalia e dytë, e pikës 7, si dhe pika 11 shfuqizohen.

Neni 38

Neni 77 shfuqizohet.

Neni 39

Dispozita të fundit dhe kalimtare

Çdo parashikim ligjor e nënligjor, që bie në kundërshtim me dispozitat e nenit 59, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, siç është ndryshuar nga neni 30, i këtij ligji, shfuqizohet.

Neni 40

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 19.02.2015.

**Shpallur me dekretin nr. 8990, datë 6.3.2015
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

**LIGJ**
Nr. 9/2015**PËR MEDALJET NË FORCAT E**
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:****KREU I**
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**Neni 1**
Objekti

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i medaljeve, kriterëve dhe autoriteteve që kanë të drejtën e dhënies së tyre, për personelin ushtarak dhe civil që shërben në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe për ushtarakët e huaj që shquhen për merita dhe kontribute të veçanta për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim njohjen e kontributit dhe përkushtimit të personelit ushtarak dhe civil, që shërben në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në mbrojtje të interesave të vendit dhe kryerjes me përgjegjësi të lartë të detyrave, si dhe ushtarakëve të huaj, për merita dhe kontribute të veçanta për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë territorit të saj, ku personeli i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dërgohet me mision, operacion ushtarak, shërbim, stërvitje të përbashkët ose mision diplomatik.

Neni 4
Subjektet

Subjekte të këtij ligji janë ushtarakët aktivë, në rezervë, në lirim ose në pension, personeli civil, repartet e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe ushtarakët e huaj.

KREU II
MEDALJET NË FORCAT E
ARMATOSURA**Neni 5**
Autoritetet përgjegjëse

Përveç dekoratave dhe titujve të nderit, që jepen nga autoritete të tjera, sipas legjislacionit në fuqi, për subjektet e përcaktuara në nenin 4, të këtij ligji, jepen medalje nga këto autoritete:

- a) Ministri i Mbrojtjes;
- b) Shefi i Shtabit të Përgjithshëm;
- c) komandantët e forcave;
- ç) komandantët e komandave mbështetëse;
- d) komandantët e batalioneve/flotiljeve/regjimenteve;
- dh) komandantët e kompanive.

Neni 6
Llojet e medaljeve

1. Ministri i Mbrojtjes jep këto medalje:
 - a) “Medalja e nderit”;
 - b) “Medalja e mirënjohjes”;
 - c) “Në shërbim të atdheut”.
 - ç) “Për shërbime të shquara”;
 - d) “Për shërbime të larta”.
2. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura jep këto medalje:
 - a) “Medalja shpëtimtari”;
 - b) “Medalja e trimërisë”;
 - c) “Medalja e sakrificës”;
 - ç) “Medalja e karrierës”;
 - d) “Për shërbime të veçanta”;
 - dh) “Repart i shquar”;
 - e) “Medalja luftëtar”;
 - ë) “Pjesëmarrje në operacione humanitare”;
 - f) “Pjesëmarrje në emergjenca civile”.
3. Komandantët e forcave dhe komandave mbështetëse japin këto medalje:
 - a) “Medalja e ushtarit”;
 - b) “Medalja e pilotit”;



- c) “Medalja e marinarit”;
- ç) “Medalja e dijes”;
- d) “Medalja e mbështetjes”;
- dh) “Medalja e karrierës”.

4. Komandantët e batalioneve/flotiljeve/regjimenteve japin këto medalje:

- a) “Syri i shqiponjës”;
- b) “Nderi i batalionit/flotiljes/regjimentit”.

5. Komandantët e kompanive japin medaljen “Nderi i kompanisë”.

Neni 7

“Medalja e nderit”

“Medalja e nderit” është medalja më e lartë që i jepet ushtarakëve aktivë, në rezervë dhe në lirim, të Forcave të Armatosura, për trimëri, guxim dhe kontribut të spikatur, duke rrezikuar jetën përtej asaj çfarë kërkon detyra.

Neni 8

“Medalja e mirënjohjes”

“Medalja e mirënjohjes” u jepet ushtarakëve aktivë, në rezervë, në lirim ose në pension, personelit civil dhe reparteve të Forcave të Armatosura, të cilët janë dalluar për kontributin dhe vlerat e veçanta në shërbim të lartësimit të figurës së ushtarakut të Forcave të Armatosura brenda dhe jashtë vendit. Kjo medalje u jepet edhe ushtarakëve të huaj, të cilët kanë dhënë një kontribut të veçantë në shërbim të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 9

Medalja “Në shërbim të atdheut”

Medalja “Në shërbim të atdheut” u jepet ushtarakëve aktivë, në rezervë, në lirim dhe personelit civil të Forcave të Armatosura që shërben, në kohë lufte, për mbrojtjen e atdheut.

Neni 10

Medalja “Për shërbime të shquara”

Medalja “Për shërbime të shquara” u jepet ushtarakëve aktivë dhe personelit civil të Forcave të Armatosura që janë dalluar, në kohë paqeje, për shërbime të merituar në detyrat me përgjegjësi të lartë.

Neni 11

Medalja “Për shërbime të larta”

Medalja “Për shërbime të larta” i jepet personelit civil të Forcave të Armatosura për arritje të veçanta në kryerjen e detyrave të tyre, për një periudhë jo më pak se 5 vjet.

Neni 12

“Medalja shpëtimtari”

“Medalja shpëtimtari” u jepet ushtarakëve aktivë/në rezervë dhe personelit civil të Forcave të Armatosura, të dalluar për heroizëm në shpëtimin e jetës së njeriut, duke rrezikuar jetën e tyre. Kjo medalje u jepet edhe ushtarakëve të huaj.

Neni 13

“Medalja e trimërisë”

“Medalja e trimërisë” u jepet ushtarakëve aktivë dhe në rezervë të Forcave të Armatosura, të cilët tregojnë trimëri e guxim të veçantë gjatë zhvillimit të operacioneve ushtarake, brenda dhe jashtë vendit.

Neni 14

“Medalja e sakrificës”

“Medalja e sakrificës” u jepet ushtarakëve aktivë/në rezervë dhe personelit civil të Forcave të Armatosura, të plagosur gjatë operacioneve luftarake dhe jo luftarake, brenda dhe jashtë vendit.

Neni 15

“Medalja e karrierës”

“Medalja e karrierës” u jepet ushtarakëve aktivë, që shërbejnë në Ministrinë e Mbrojtjes, Shtabin e Përgjithshëm dhe strukturat e tyre të varësisë, nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, dhe ushtarakëve aktivë, që shërbejnë në forcat dhe strukturat mbështetëse, nga komandantët e forcave dhe komandantët e strukturave mbështetëse, për çdo 10 vjet shërbim në Forcat e Armatosura.

Neni 16

Medalja “Për shërbim të veçantë”

Medalja “Për shërbim të veçantë” u jepet ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura që



shfaqin sjellje shembullore dhe kanë arritur tregues të lartë gjatë detyrës, për një periudhë 5-vjeçare. Kjo medalje mund të jepet çdo 5 vjet nga koha e marrjes së medaljes së fundit.

Neni 17

“Medalja luftëtari”

“Medalja luftëtari” u jepet ushtarakëve aktivë dhe reparteve të Forcave të Armatosura që kanë marrë pjesë, për një periudhë kohore jo më pak se 3 muaj, në operacione të ndryshme ushtarake ndërkombëtare. Mbishkrimi i këtyre medaljeve ndryshon në varësi të emërtesës së çdo misioni të veçantë.

Neni 18

Medalja “Pjesëmarrje në operacione humanitare”

Medalja “Pjesëmarrje në operacione humanitare” u jepet ushtarakëve aktivë, personelit civil dhe reparteve të Forcave të Armatosura për pjesëmarrjen e tyre në operacione humanitare brenda dhe jashtë vendit. Mbishkrimi i këtyre medaljeve ndryshon në varësi të emërtesës së çdo operacioni të veçantë.

Neni 19

Medalja “Pjesëmarrje në emergjencë civile”

Medalja “Pjesëmarrje në emergjencë civile” u jepet ushtarakëve aktivë, personelit civil dhe reparteve të Forcave të Armatosura për pjesëmarrjen e tyre në operacione të përballimit të emergjencave civile brenda dhe jashtë vendit. Mbishkrimi i këtyre medaljeve ndryshon në varësi të emërtesës së çdo operacioni të veçantë.

Neni 20

Medalja “Repart i shquar”

Medalja “Repart i shquar”, u jepet reparteve të Forcave të Armatosura që kanë treguar trimëri e vendosmëri të lartë gjatë përmbushjes së misionit, përmes vështirësive të mëdha.

Neni 21

“Medalja e ushtarit”

“Medalja e ushtarit” u jepet, nga Komandanti i Forcës Tokësore, ushtarakëve aktivë, që kanë

shërbyer jo më pak se 5 vjet në Forcën Tokësore dhe kanë spikatur me performancën e tyre në detyrën apo detyrat që kanë kryer.

Neni 22

“Medalja e pilotit”

“Medalja e pilotit” u jepet, nga Komandanti i Forcës Ajrore, ushtarakëve aktivë, të cilët gjatë shërbimit ushtarak kanë kryer jo më pak se 500 orë fluturimi si komandant ekuipazhi.

Neni 23

“Medalja e marinarit”

“Medalja e marinarit” u jepet, nga Komandanti i Forcës Detare, ushtarakëve aktivë, të cilët gjatë shërbimit ushtarak kanë shërbyer në mjete lundruese jo më pak se 5 vjet dhe kanë spikatur me performancën e tyre në detyrën apo detyrat që kanë kryer.

Neni 24

“Medalja e dijes”

“Medalja e dijes” u jepet, nga Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura, të cilët dallohen në përvetësimin e njohurive mësimore ose gjatë zhvillimit të një kursi të caktuar, jo më të shkurtër se 6 muaj.

Neni 25

“Medalja e mbështetjes”

“Medalja e mbështetjes” u jepet, nga Komandanti i Komandës Mbështetëse, ushtarakëve aktivë që kanë shërbyer në Komandën Mbështetëse jo më pak se 5 vjet për shërbime dhe arritje të merituar gjatë kryerjes së detyrave.

Neni 26

Medalja “Syri i shqiponjës”

Medalja “Syri i shqiponjës” u jepet, nga komandanti i batalionit/flotiljes/ regjimentit, ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura, të cilët dallohen në përdorimin e armëve të zjarrit, sipas standardeve të përcaktuara nga Forcat e Armatosura.



Neni 27

Medalja “Nderi i batalionit/flotiljes/regjimentit”

Medalja “Nderi i batalionit / flotiljes / regjimentit” u jepet, nga komandanti i batalionit / flotiljes / regjimentit, ushtarakëve aktivë, të cilët kanë arritur rezultate të larta gjatë punës së tyre dhe marrin vlerësimet maksimale për një periudhë jo më pak se 5 vjet.

Neni 28

Medalja “Nderi i kompanisë”

Medalja “Nderi i kompanisë” u jepet, nga komandanti i kompanisë, ushtarakëve aktivë, të cilët kanë arritur rezultate të larta gjatë punës së tyre dhe marrin vlerësimet maksimale për një periudhë jo më pak se 3 vjet.

KREU III

MODELI, DHËNIA, MBAJTJA DHE SHPËRBLIMI I MEDALJEVE

Neni 29

Modelet dhe përshkrimet

1. Medaljet përbëhen prej 1 medaljeje dhe 1 certifikate.

2. Modeli dhe përshkrimi i medaljeve dhe certifikatës, rregullat dhe procedurat për propozimet, shqyrtimet dhe dhënien e tyre, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

Neni 30

Mënyra e dhënies së medaljeve

1. Dhënia e medaljeve bëhet me ceremoni zyrtare nga autoritetet përkatëse, sipas këtij ligji.

2. Dhënia e medaljeve bëhet në prani të efektivit të repartit, të pjesëtarëve të familjes dhe të ftuarve të tjerë.

3. Dhënia e medaljeve, për ushtarakët e huaj, bëhet sipas një procedure të miratuar me udhëzim të Ministrit të Mbrojtjes.

4. Medaljet e përcaktuara në nenet 15, 17, 22 dhe 23, të këtij ligji, jepen, në çdo rast, me plotësimin e kushteve për dhënien e tyre.

Neni 31

Mbajtja e medaljeve

1. Ushtarakët aktivë, në rezervë, në lirim ose në pension, si dhe punonjësit civilë të Forcave të Armatosura, përveç medaljeve të dhëna, sipas këtij ligji, gëzojnë të drejtën të mbajnë edhe medalje, dekorata e tituj nderi të dhëna nga institucione dhe autoritete të tjera publike, si dhe nga institucione dhe autoritete të shteteve të tjera.

2. Mënyra e mbajtjes së medaljeve në uniformën ushtarake, si dhe rastet kur lejohet të mbahen medaljet e marra nga institucionet dhe autoritetet e tjera publike dhe institucionet e autoritetet e shteteve të tjera, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Neni 32

Shpërblimi për medaljet

1. Dhënia e medaljeve shoqërohet me një shpërblim financiar.

2. Lloji i medaljes, për të cilën do të jepet shpërblim, dhe masa e shpërblimit të saj përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

KREU IV

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 33

Njohja e medaljeve

Medaljet që janë dhënë përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, njihen.

Neni 34

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore, në zbatim të neneve 29, pika 2, dhe 32, pika 2, të këtij ligji.

2. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore, në zbatim të neneve 30, pika 3, dhe 31, pika 2, të këtij ligji.



Neni 35

Aktet nënligjore në fuqi

Aktet nënligjore, të nxjerra para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, do të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 36

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 19.02.2015

Shpallur me dekretin nr. 8991, datë 6.3.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ**Nr. 10/2015****PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 112/2013, “PËR DEKORATAT, TITUJT E NDERIT, MEDALJET DHE TITUJT VENDORË TË NDERIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

Në ligjin nr. 112/2013, “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 9, shkronja “c” shfuqizohet.

Neni 2

Neni 11 shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 23, pika 3, fjalët “të përbashkët të ministrit përgjegjës për Forcat e Armatosura dhe” hiqen.

Neni 4

Në nenin 26, pika 2, fjalët “dhe ministri përgjegjës për Forcat e Armatosura” hiqen

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 19.02.2015.

Shpallur me dekretin nr. 8992, datë 6.3.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ**Nr. 11/2015****PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MARRËVESHJEN SHUMËPALËSHE NDËRMJET VENDEVE TË EUROPËS JUGLINDORE PËR ZBATIMIN E KONVENTËS “PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT MJEDISOR NË KONTEKST NDËRKUFITAR”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në marrëveshjen shumëpalëshe ndërmjet vendeve të Europës Juglindore për zbatimin e konventës “Për vlerësimin e ndikimit mjedisor në kontekst ndërkufitar” (ESPOO).

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 19.02.2015

Shpallur me dekretin nr. 8993, datë 6.3.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani



MARRËVESHJE SHUMËPALËSHE NDËRMJET SHTETEVE TË EUROPËS JUG LINDORE PËR ZBATIMIN E KONVENTËS PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT MJEDISOR NË KONTEKST NDËRKUFITAR

Palët e kësaj Marrëveshjeje,

duke marrë parasysh se jo të gjitha palët e kësaj Marrëveshjeje janë palë në Konventën e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor në Kontekst Ndërkufitar,

duke dëshiruar të zbatojnë hollësisht dispozitat e kësaj Konvente,

kanë rënë dakord sa më poshtë:

Neni 1

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje,

1. “Palë” nënkupton, nëse konteksti nuk përcakton ndryshe, një Palë Kontraktuese në këtë Marrëveshje.

2. “Palë e Origjinës” nënkupton Palën ose Palët Kontraktuese në këtë Marrëveshje nën juridiksionin e së cilës është parashikuar të zhvillohet një aktivitet i propozuar.

3. “Palë e Cenuar” nënkupton Palën ose Palët Kontraktuese në këtë Marrëveshje që mund të preken nga ndikimi ndërkufitar i një aktiviteti të propozuar.

4. “Palë të interesuara” nënkupton Palën e Origjinës dhe Palën e Cenuar të një vlerësimi të ndikimit mjedisor në zbatim të kësaj Marrëveshjeje.

5. “Aktivitet i propozuar” nënkupton çdo aktivitet ose çdo ndryshim kryesor të ndonjë aktiviteti në bazë të një vendimi të një autoriteti kompetent, në përputhje me procedurat e zbatueshme kombëtare.

6. “Aktivitet i propozuar i përbashkët” nënkupton një aktivitet të propozuar që është parashikuar të zhvillohet nën juridiksionin e më shumë se një Pale.

7. “Vlerësim i ndikimit mjedisor” nënkupton një procedurë kombëtare për vlerësimin e ndikimit potencial në mjedis të një aktiviteti të propozuar.

8. “Ndikim” nënkupton çdo efekt të shkaktuar në mjedis nga një aktivitet i propozuar, duke përfshirë shëndetin dhe sigurinë e njerëzve, florën, faunën, tokën, ajrin, ujin, klimën,

peizazhin dhe monumentet historike apo struktura të tjera fizike ose ndërveprimi midis këtyre faktorëve; përfshin gjithashtu efektet në trashëgiminë kulturore ose kushtet social-ekonomike që rezultojnë nga ndryshimet e këtyre faktorëve.

9. “Ndikim ndërkufitar” nënkupton çdo ndikim jo vetëm të një karakteri global, brenda një zone nën juridiksionin e një Pale, të shkaktuar nga një aktivitet i propozuar, origjina fizike e të cilit është vendosur tërësisht ose pjesërisht brenda zonës nën juridiksionin e një Pale tjetër.

10. “Autoritet kompetent” nënkupton autoritetin kombëtar ose autoritetet e përcaktuara nga një Palë si përgjegjëse për kryerjen e detyrave të mbuluara nga kjo Marrëveshje dhe/ose autoriteti apo autoritetet e besuara nga një Palë me fuqi vendimmarrëse në lidhje me një aktivitet të propozuar.

11. “Pikë e kontaktit” nënkupton një person përgjegjës për dërgimin dhe marrjen e njoftimeve sipas kësaj Marrëveshjeje.

12. “Publik” nënkupton një ose më shumë persona fizikë ose juridikë dhe në përputhje me legjislacionin ose praktikën kombëtare, shoqatat, organizatat ose grupet tyre.

13. “Konventë” nënkupton Konventën për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor në Kontekst Ndërkufitar, të hartuar në ESPOO (Finlandë) në datën 25 shkurt të vitit 1991.

Neni 2

1. Çdo Palë cakton autoritetin e tyre kompetent dhe pikën e kontaktit, dhe si rrjedhojë informon Palët e tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe sekretariatit të Konventës brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Brenda 30 ditëve nga çdo ndryshim i mëvonshëm i autoritetit të tyre kompetent apo në pikën e kontaktit, çdo Palë do të informojë rrjedhimisht Palët e tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe sekretariatit të Konventës.

Neni 3

Palët marrin masat e nevojshme ligjore, administrative ose masa të tjera për zbatimin e dispozitave të Konventës ndërmjet tyre.



Neni 4

Secila Palë merr masat e nevojshme ligjore, administrative ose masa të tjera për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje për aktivitetet e propozuara të renditura në shtojcën I të Konventës që mund të shkaktojnë ndikim të rëndësishëm negativ ndërkufitar.

Neni 5

1. Palët miratojnë kriteret për identifikimin e ndikimit të rëndësishëm negativ ndërkufitar, në bazë të kriterëve të përgjithshme të përcaktuara në shtojcën III të Konventës.

2. Palët zhvillojnë udhëzime për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje në bazë të elementeve të mëposhtme, midis të tjerash: shfaqjen, njoftimin, konfirmimin e pjesëmarrjes, transmetimin e informacionit, përgatitjen e dokumentacionit të vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe shpërndarjen e tij, pjesëmarrjen publike, konsultimet ndërmjet Palëve, vendimin dhe transmetimin e vendimit përfundimtar, post-projekt analizën dhe përkthimin.

3. Kriteret e miratuara në përputhje me paragrafin 1 përdoren për zhvillimin e udhëzimeve të parashikuara në paragrafin 2.

Neni 6

1. Për një aktivitet të përbashkët të propozuar, secila prej Palëve nën juridiksionin e të cilave është parashikuar të zhvillohet aktiviteti i propozuar, konsiderohet si Pala e Origjinës dhe Pala e Cenuar. Këto Palë formojnë një ose më shumë grupe të përbashkëta pune për të përcaktuar masat e hollësishme për komunikim dhe konsultime.

2. Kur këto palë bien dakord, nenet 7 deri 11 nuk zbatohen për aktivitetin e përbashkët të propozuar për ato palë.

Neni 7

1. Pika e kontaktit të Palës së Origjinës, kur vihet në dijeni se aktiviteti i propozuar parashikohet nga neni 4, duhet të njoftojë pa vonesë pikën e kontaktit të Palës së Cenuar.

2. Nëse legjislacioni kombëtar i vlerësimit të ndikimit mjedisor i Palës së Origjinës përfshin një fazë fillestare, pika e kontaktit e Palës së Origjinës

duhet të njoftojë pikën e kontaktit të Palës së Cenuar në atë fazë ose më herët.

3. Pika e kontaktit e Palës së Cenuar duhet t'i përgjigjet pikës së kontaktit të Palës së Origjinës brenda 30 ditëve nga momenti që merr njoftimin dhe duhet të përcaktojë nëse Pala e Cenuar synon të marrë pjesë në procedurat e vlerësimit të ndikimit mjedisor.

4. Njoftimi duhet të përmbajë informacionin e përfshirë në aneks.

5. Nëse Pala e Cenuar përcakton se nuk synon të marrë pjesë në procedurat e vlerësimit të ndikimit mjedisor ose nuk përgjigjet në kohë, dispozitat në nenet 9 deri 14 nuk do të zbatohen.

Neni 8

1. Pala e Origjinës duhet të vërë në dispozicion njoftimin në gjuhën angleze dhe të specifikojë nëse përgjigja duhet të jetë në gjuhën angleze.

2. Pala e Cenuar duhet t'i përgjigjet njoftimit për të dhënë informacion në lidhje me mjedisin potencial të prekur dhe për të dhënë komentet e publikut dhe të autoriteteve të Palës së Cenuar, në gjuhën angleze, nëse kërkohet nga Pala e Origjinës.

3. Pala e Cenuar mund të specifikojë që komunikime të mëtejshme dhe dokumentacioni i vlerësimit të ndikimit mjedisor do të vihen në dispozicion në gjuhën angleze.

4. Dokumentacioni i mëposhtëm duhet të përkthehet nga propozuesi i aktivitetit të propozuar në gjuhën zyrtare të tij dhe të specifikohet nga Pala e Cenuar:

a) Përshkrimi i aktivitetit të propozuar dhe qëllimi i tij;

b) Përmbledhja joteknike;

c) Përshkrimi i ndikimit potencial të mjedisit ndërkufitar të aktivitetit të propozuar dhe alternativat e tij dhe një vlerësim të rëndësishëm të tij;

d) Përshkrimi i masave zbutëse për të ruajtur në nivel minimal ndikimin ndërkufitar mjedisor negativ.

Neni 9

Palët e interesuara mund të formojnë një ose më shumë grupe të përbashkëta pune për komunikime të mëtejshme dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet Palëve të interesuara.



Neni 10

1. Autoriteti kompetent i Palës së Origjinës do të konsultohet me autoritetin kompetent të Palës së Cenuar, nëpërmjet grupeve të përbashkëta të punës, nëse janë krijuar, në marrëveshje për shpërndarjen e dokumentacionit të vlerësimit të ndikimit mjedisor për autoritetet dhe publikun e Palës së Cenuar, duke përfshirë:

a) Numrin e kopjeve të dokumentacionit të vlerësimit të ndikimit mjedisor, të nevojshme për Palën e Cenuar si dhe në marrëveshjet e veçanta, të tilla si vendndodhja dhe koha, për marrjen e dokumentacionit të vlerësimit të ndikimit mjedisor në dispozicion të publikut të Palës së Cenuar;

b) Nëse komentet e dorëzuara nga publiku i Palës së Cenuar do t'i dërgohen drejtpërdrejt autoritetit kompetent të Palës së Origjinës, ose nëse ata do të pranohen nga autoriteti kompetent i Palës së Cenuar dhe më pas kalojnë në tërësinë e tyre tek autoriteti kompetent i Palës së Origjinës.

2. Për të garantuar një proces në përputhje me kohën e procedurës së vlerësimit të ndikimit mjedisor kombëtar të Palës së Origjinës, Palët e interesuara do të kërkojnë që të paraqitet dokumentacioni i vlerësimit të ndikimit mjedisor tek autoritetet dhe te publiku i Palës së Cenuar paralelisht me dorëzimin e tij tek autoritetet dhe publiku i Palës së Origjinës.

Neni 11

Dokumentacioni i vlerësimit të ndikimit mjedisor duhet të përmbajë minimalisht informacionin e përshkruar në shtojcën II të Konventës.

Neni 12

Palët do të sigurojnë që vendimi përfundimtar për veprimtarinë e propozuar specifikon se si komentet nga publiku dhe autoriteteve të Palës së Cenuar janë marrë në konsideratë. Komentet duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe pa marrë parasysh kufijtë kombëtarë.

Neni 13

Nëse legjislacioni i Palës së Origjinës përfshin mundësinë për publikun apo autoriteteve nga Pala e Cenuar që të kenë akses në procedurat

administrative ose gjyqësore për të kundërshtuar vendimet përfundimtare mbi një aktivitet të propozuar, vendimi përfundimtar do të përfshijë informacion në lidhje me këtë mundësi.

Neni 14

Autoritetet kompetente të Palëve të interesuara mund të bien dakord për të kryer një analizë ose monitorim post-projekti. Përmbajtja specifike e analizës së post-projektit duhet të bihet dakord ndërmjet tyre dhe në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar.

Neni 15

Nëse një Palë potencialisht e Cenuar dëshiron të njoftohet rreth një veprimtarie të propozuar, Pala e Cenuar dhe Pala e Origjinës duhet të hyjnë pa vonesë në konsultime, me qëllim gjetjen e një marrëveshjeje të përbashkët nëse aktiviteti i propozuar i nënshtrohet nenit 4.

Neni 16

Palët do të takohen me kërkesë me shkrim të çdo pale, me kusht që brenda 90 ditëve nga komunikimi i kërkesës, është mbështetur të paktën nga një Palë tjetër.

Neni 17

Anekset e kësaj Marrëveshjeje do të përbëjnë pjesë integrale të saj.

Neni 18

1. Çdo Palë mund të propozojë amendamente të kësaj Marrëveshjeje. Amendamentet e propozuara do t'i dorëzohen në formë të shkruar të gjitha Palëve.

2. Palët do të takohen në bazë të nenit 16 për të diskutuar amendamentet e propozuara.

3. Nenet 20 deri 24 do të zbatohen, *mutatis mutandis*, për ndryshime në këtë Marrëveshje, miratuar me konsensus ndërmjet palëve.

Neni 19

Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për nënshkrim në Bukuresht më 20 dhe 21 maj 2008.



Neni 20

Qeveria e Rumanisë do të veprojë si depozitari i kësaj Marrëveshjeje.

Neni 21

1. Kjo Marrëveshje do t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit nga shtetet nënshkruese.

2. Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për aderim nga data 22 maj 2008.

3. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit do të depozitohen sa më shpejt të jetë e mundur pranë depozitarit. Depozitari duhet të informojë Palët për datën e depozitimit të çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

Neni 22

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

2. Për çdo shtet që ratifikon, pranon, miraton ose aderon në këtë Marrëveshje pas depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, Marrëveshja do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit nga ky shtet të instrumenti të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

Neni 23

Në çdo kohë, pas dy viteve nga data në të cilën kjo Marrëveshje ka hyrë në fuqi në lidhje me një Palë, kjo Palë mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje duke dhënë njoftimin me shkrim të depozitarit. Çdo tërheqje e tillë do të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas datës së marrjes së tij nga depozitari. Çdo tërheqje e tillë nuk do të ndikojë në zbatimin e neneve 7 deri 13 për një aktivitet të propozuar në lidhje me të cilat njoftimi është kryer tashmë në përputhje me nenin 7, paragrafi 1, para hyrjes në fuqi të kësaj tërheqjeje.

Neni 24

Originali i kësaj Marrëveshjeje, versioni në gjuhën angleze i të cilës është teksti autentik, do të depozitohet pranë Qeverisë së Rumanisë.

Në dëshmi të kësaj, të poshtësënuarit, duke qenë në mënyrë të rregullt të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Bukuresht në ditën e njëzetë të muajit maj, dy mijë e tetë.

SHTOJCË

Informacioni i përmendur në nenin 7, paragrafi 4

1. Informacion mbi aktivitetin e propozuar:

a) Informacion për natyrën e aktivitetit të propozuar:

i) Lloji i aktivitetit të propozuar;

ii) Nëse aktiviteti i propozuar është i renditur në Shtojcën I të Konventës (po/jo);

iii) Qëllimi i aktivitetit të propozuar (p.sh. aktiviteti kryesor dhe ndonjë apo të gjitha aktivitetet periferike që kërkojnë vlerësim);

iv) Shkalla e aktivitetit të propozuar (p.sh., madhësia, kapaciteti i prodhimit);

v) Përshkrimi i aktivitetit të planifikuar (p.sh. teknologjia që përdoret);

vi) Përshkrimi i qëllimit të veprimtarisë së propozuar;

vii) Arsyeja për aktivitetin e propozuar (p.sh. baza socio-ekonomike, gjeografike-fizike);

viii) Informacione plotësuese dhe komentet.

b) Informacion mbi kufijtë hapësinorë dhe kohorë të veprimtarisë së propozuar:

i) Vendndodhja;

ii) Përshkrimi i vendndodhjes (p.sh. karakteristikat fiziko-gjeografike ose socio-ekonomike);

iii) Arsyeja për vendndodhjen e aktivitetit të propozuar (p.sh. baza socio-ekonomike apo fiziko-gjeografike);

iv) Afati kohor për aktivitetin e propozuar (p.sh. fillimi dhe kohëzgjatja e ndërtimit dhe operacionit);

v) Harta dhe dokumente të tjera të ilustruara të lidhura me informacionin mbi aktivitetin e propozuar;

vi) Informacione plotësuese dhe komente.

c) Informacion mbi ndikimet e pritshme mjedisore dhe masat lehtësuese të propozuara:

i) Qëllimi i vlerësimit (p.sh. shqyrtimi i ndikimeve kumulative, vlerësimi i alternativave, çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm, ndikimi i aktiviteteve periferike);



ii) Ndikimet e pritura mjedisore të aktivitetit të propozuar (p.sh. llojet, vendet, madhësitë);

iii) Inputet (p.sh., uji, toka, materiale të papërpunuara, burimet e energjisë);

iv) Rezultatet (p.sh. shumat dhe llojet e emetimeve në atmosferë, shkarkimet në sistemin e ujit, mbetjeve të ngurta);

v) Ndikimet ndërkufitare (p.sh. llojet, vendndodhja, madhësitë);

vi) Masat lehtësuese të propozuara (p.sh. nëse dihet, masat lehtësuese për të parandaluar, eliminuar, minimizuar dhe kompensuar ndikimet mjedisore);

vii) Informacione plotësuese dhe komente.

d) Përmbledhja dhe koha e konsultimit të propozuar, duke përfshirë një përmbledhje të procesit të ankesës apo procedurës së ankimit;

e) Propozuesi ose zhvilluesi (detajet e personit të kontaktit):

i) Emri, adresa, numrat e telefonit dhe faksit;

f) Vlerësimi i ndikimit mjedisor (VNM), dokumentacioni dhe procedura:

i) nëse dokumentacioni i VNM-së (p.sh. raporti VNM-së apo Deklarata e Ndikimit Mjedisor) është përfshirë në njoftimin (Po/Jo/pjesërisht);

ii) Nëse jo, ose pjesërisht, nëse përshkrimi i dokumentacionit shtesë duhet të dërgohet dhe, nëse po (përafërsisht) data/t kur dokumentacioni do të jetë në dispozicion;

iii) Planifikimi kohor;

iv) Detajet e personit të kontaktit (Pala e Origjinës);

v) Autoriteti përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve që lidhen me procedurën e vlerësimit të ndikimit mjedisor;

vi) Emri, adresa, numrat e telefonit dhe faksit;

vii) Informacione plotësuese dhe komente.

2. Pikat e kontaktit:

a) Pikat e kontaktit për Palët e mundshme të Cenuara:

i) Autoriteti përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve që lidhen me VNM-në; me emër, adresë, numrat e telefonit dhe faksit;

ii) Lista e Palëve të Cenuara tek të cilat është dërguar njoftimi;

b) Pikat e kontaktit për Palën e Origjinës:

i) Autoriteti përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve në lidhje me VNM-në, me emër, adresë, numrat e telefonit dhe faksit;

ii) Autoriteti vendimmarrës, nëse është i ndryshëm nga autoriteti përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve që lidhen me VNM-në, me emrin, adresën, numrat e telefonit dhe faksit.

3. Informacion mbi procesin e vlerësimit të ndikimit mjedisor në Palën e Origjinës që do të zbatohet për aktivitetin e propozuar:

a) Planifikimi kohor;

b) Mundësi për Palën e Cenuar apo palët që do të përfshihen në procesin e VNM-së;

c) Mundësi për palë të prekur ose palë që të rishikojnë dhe komentojnë njoftimin dhe dokumentacionin e VNM-së;

d) Natyra dhe koha e vendimeve të mundshme;

e) Procesi për miratimin e veprimtarisë së propozuar;

f) Informacione dhe komente shtesë.

4. Informacion mbi procesin e pjesëmarrjes së publikut të Palës së Origjinës:

a) procedurat e pjesëmarrjes së publikut;

b) fillimin e pritshëm dhe kohëzgjatjen e konsultimit publik;

c) Informacione dhe komente shtesë.

5. Afati për përgjigje.

VENDIM

Nr. 35/2015

PËR DISA NDRYSHIME NË STRUKTURËN, ORGANIKËN DHE KATEGORIZIMIN E POZICIONEVE TË PUNËS TË AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE (AMA)

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 9 e 10 të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblymjet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, pika 2, dhe të nenit 19, pika 17, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Autoritetit të Mediave Audiovizive,



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lidhja nr. 1, sipas vendimit të Kuvendit nr. 184, datë 19.5.2008, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit”, ndryshohet sipas lidhjes me të njëjtin numër, me emërtesën “Struktura e Autoritetit të Mediave Audiovizive”, dhe i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.

II. Lidhja nr. 2, sipas vendimit të Kuvendit nr.


184, datë 19.5.2008, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicionit të punës të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit”, ndryshohet sipas lidhjes me të njëjtin numër, me emërtesën “Organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës të Autoritetit të Mediave Audiovizive”, dhe i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 26.2.2015

LIDHJA NR. 1





LIDHJA NR. 2

ORGANIKA DHE KATEGORIZIMI I POZICIONEVE TË PUNËS TË AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Funksioni	Nr. i punonjësve	Kategoria/Klasa
Kryetar	1	Ligj 9584/2006 Grupi D
- Sekretar	1	VKM nr. 545/2011, i ndryshuar
Kabineti	2	
- Drejtor Kabineti	1	II-a
- Këshilltar	1	II-b
Zëvendëskryetar	1	Ligj 9584/2006 Grupi F
Sekretari i Përgjithshëm	1	I-b
Këshilli i Ankesave	3	
- Kryetar	1	II-b (VKM nr. 545/2011, i ndryshuar)
- Anëtar	1	III-a (VKM nr. 545/2011, i ndryshuar)
- Anëtar	1	III-a (VKM nr. 545/2011, i ndryshuar)
DREJTORIA E PROGRAMEVE	17	
- Drejtor	1	II-b
- Spektori Programeve		
- Përgjegjës sektori	1	III-a
- Specialist	1	III-b
- Specialist	1	III-b
- Spektori i Informacionit dhe Reklamave		
- Përgjegjës sektori	1	III-a
- Specialist	1	III-b
- Spektori i Studios së Monitorimit		
- Përgjegjës i studios së monitorimit	1	III-a
- Monitorues	1	IV-a
- Monitorues	1	IV-a
- Monitorues	1	IV-a
- Monitorues	1	IV-a
- Monitorues	1	IV-a
- Monitorues	1	IV-a
- Monitorues	1	IV-a
- Monitorues	1	IV-a
- Monitorues	1	IV-a
- Teknik	1	klasa VII
- Teknik	1	klasa VII
DREJTORIA TEKNIKE	7	
- Drejtor	1	II-b
- Spektori i Planifikimit dhe Administrimit të Frekuencave		



- Përgjegjës sektori	1		III-a
- Specialist radio	1		III-b
- Specialist Tv	1		III-b
- Spektori i Monitorimit të Frekuencave			
- Përgjegjës sektori	1		III-a
- Specialist	1		III-b
- Specialist	1		III-b
DREJTORIA JURIDIKE	6		
- Drejtor	1		II-b
- Spektori i Çështjeve Juridike			
- Përgjegjës sektori	1		III-a
- Specialist	1		III-b
- Specialist	1		III-b
- Spektori i së Drejtës së Transmetimit dhe së Drejtës së Autorit			
- Përgjegjës sektori	1		III-a
- Specialist	1		III-b
DREJTORIA EKONOMIKE	3		
- Drejtor	1		II-b
- Specialist	1		III-b
- Specialist për buxhetin	1		IV-a
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE	12		
- Drejtor	1		II-b
- Spektori i Marrëdhënieve me Jashtë dhe Publikun			
- Përgjegjës sektori	1		III-a/1
- Specialist i marrëdhënieve me jashtë dhe koordinimin e projekteve	1		IV-a
- Specialist i marrëdhënieve me publikun	1		IV-a
- Specialist i IT	1		III-b
- Zyra e Arkiv-Protokollit			
- Arkivist - protokollist	1	klasa	VII
- Spektori i administratës			
- Përgjegjës sektori	1		III-a/1
- Magazinier	1	klasa	VI
- Shofer	1	klasa	IV
- Shofer	1	klasa	IV
- Punëtore	1	klasa	II
- Punëtore pastrimi	1	klasa	I
GJITHSEJ	54		

VENDIM
Nr. 36/2015

**PËR ZGJEDHJEN E ZONJËS DENADA
PRIFTI ANËTARE E KËSHILLIT
MBIKËQYRËS TË BANKËS SË
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 44, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Denada Prifti zgjidhet anëtare e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 26.2.2015

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 224 lekë